

Parlament
KSHZ mund të
zgjidhet edhe
pa dy të tretat

Fq.4



**PËRFSHIRJA
E RUSISË**
Savidi, nxitës
i trazirave
në Maqedoni

Fq.6



S'kam ardhur
me pushime,
do t'ju
befasoj

Fq.21



Koha

www.koha.mk

**Dhe fitues
është...
Putini!**

Fq.17

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3416 · e mërkurë, 18 korrik 2018

19°C | 28°C

15 DEN

KULTURË

**Shkupi i
dikurshëm,
Vjena
kulturore e
shqiptarëve**



Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, i udhëhequr nga dr. Sken-der Asani, po bëhet një zë i fuqishëm i afirmimit të vlerave dhe valorizimit të kriterëve historik-shkencore për të kaluarën e lavdishme të këtyre trevave, që për shumë arsye kishin qenë të mbuluar me pluhurin e harresës. Tash së fundmi nga ky Institut doli edhe një vepër kapitale që trajton një nga temat më interesante që lidhet me... Fq.15

AKTUALE

**Minimum
10 vite burg
për vrasësit e
Sazdovskit**

Fq.6

SPECIALE

**Çfarë mbetet
sot nga miti i
Che Guevarës**

Fq.12



MË VIZITËN E HANIT ZYRTARISHT FILLOI SKRININGU

NIS ME GJYQËSINË DHE SUNDIMIN E LIGJIT



Zaevi shfrytëzoi konferencën e përbashkët për shtyp me komisarin Han për t'i dërguar apel Ruisë, e cila siç tha kryeministri, duhet ta dijë se për Maqedoninë nuk ka alternativë tjetër përveç anëtarësimit të plotë në NATO dhe BE Fq.3

Kompanitë shtetërore, një e treta punojnë me humbje

Shkup, 17 korrik - Një e treta e kompanive shtetërore në Maqedoni vitin e kaluar kanë punuar me humbje. Sipas analizës së Qendrës për komunikime qytetare, të bazuar në rezultatet financiare të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, në 2017 - 114 ndërmarrje me pronar shtetin, kanë shënuar humbje prej 30 milionë euro përkundër fitimit prej 141 milionë euro. Krahasimi i të dhënave më tej tregon se këto kompa-

ni, në vitin 2016 kaluar kanë treguar humbje prej 35.4 milionë euro, që do të thotë zbutje prej pesë milionë e gjysmë të minusit negativ, apo me fjalë tjera është ulur bilanci negativ i punës së tyre në vitin 2017 në raport me vitin paraprak. Njëherësh, 36 kompani, ku shteti apo komunat paraqiten si themelues dhe pronar, kanë treguar humbje, ndërsa fitim kanë treguar 86 kompani shtetërore.... Fq.7



EDITORIAL

MEDIATIZIMI I NGJARJEVE BRENDA HAPËSIRËS SHQIPTARE



Emin AZEMI

Mediatizimi i ngjarjeve brenda hapësirës shqiptare në Ballkan kalon nëpër disa ulje e ngritje, pa ndonjë projektion më të gjerë e më gjithëpërfshirës. Prioritet e zhvillimeve i përcakton vetë natyra dhe dinamika e ngjarjeve dhe këtu s'ke si të ndërhysh, sidomos kur ato ndodhin më rrallë. Por, mediatizimi si strategji komunikimi jo vetëm që mungon në hapësirën mediatike shqiptare, por ai sikur vuan pasojat e recidivave nga e kaluara kur nuk kishte kurrfarë përpjekje për të sjellë para publikut produkte me vlera mediatike nga hapësira "përtej kufirit".

Tani çka po ndodhë? E gjithë vëmendja e publikut shqiptar është e përqendruar, bie fjala, tek zhvillimet që lidhen me procesin e përafritimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, përfshi edhe Maqedoninë, Shqipërinë, por nuk ka një vëmendje publike as të përafërt për disa ngjarje në Maqedoni, siç mund të jenë: beteja politike shqiptare në prag të referendumit, rikthimi i proceseve të montuara gjyqësore, ngjarjet kulturore etj. Kështu ndodhë, madje në përmasa edhe më drastike, me mediat e Tiranës, të cilat raportojnë në mënyrë shumë protokollare, ndërkohë që mediat shqipe në Maqedoni jo pak hapësirë u japin temave e ngjarjeve në Shqipëri.

Krejt ky redaktim i ngutshëm i mediave të Prishtinës e Tiranës, mund të mos ketë ndonjë paragjykim, por ajo që bie në sy është mungesa e interesimit për të ofruar një tablo më të gjerë mbi zhvillimet në Maqedoni. Redaktorët dhe gazetarët shqiptarë të Prishtinës, Shkupit e Tiranës takohen vetëm rastësisht dhe krejt në mënyrë sporadike trajtojnë ndonjë temë profesionale teksa pinë një kafe bashkë. Ata deri më tani nuk janë mbledhur në nivel të ndonjë forumi profesional, ndërkohë që gazetarët e hapësirave të tjera në Ballkan mblidhen herë pas herë dhe trajtojnë çështje nga fushëveprimi i tyre.

Në Tiranë, Shkup e Prishtinë nuk funksionojnë korrespondenturat e dikurshme që ishin madje edhe miniredaksi në vete. Praktika e korrespondenturave tani edhe në mediat më të mëdha botërore po shkon duke u reduktuar, por në hapësirën shqiptare ka nevojë për funksionimin e tyre, aq më tepër kur ato mund të mbahen duke koncentruar disa media dhe disa gazetarë në një zyrë të cilët do të raportojnë me një kapacitet më të plotë.

Por, edhe sikur të mos funksionojë kjo mënyrë e raportimit, ekzistojnë mundësi të shumta për t'u kompensuar mangësitë. Afërsia gjeografike dhe konsolidimi i rrjetit rrugor janë avantazhe të mjaftueshme për punë lëvizëse të ekipeve gazetareske, të cilat brenda ditës kanë mundësi të sjellin para publikut storje, të cilat do të kishin receptim të lartë dhe do të trajtoheshin sikur të kishin karakter lokal.

Për një mediatizim të mirëfilltë të temave me karakter gjithëkombëtar, do të duhej të ekzistojë një gatishmëri më e madhe e të gjithë faktorëve që kujdesen për komunikimin brendashqiptar. Por kjo nuk mund të arrihet pa përpilimin e një strategjie të përbashkët në të cilën do të skicoheshin kahet dhe veprimet konkrete që si produkt final do të kishte zgjerimin e dioptrisë për ngjarje që janë me vokacion gjithëpërfshirës.

KRENARIA JONË DO TË BUROJË NGA REZULTATET E KOSOVËS

"Kënaqësia jonë me futbollin mund të jetë e plotë kur të merr pjesë Kosova në kampionatin botëror të futbollit. Në atë rast mund të kemi qejf të fitojë edhe Zvicra e Kroacia, për inat të shkieve, por krenaria jonë do të burojë nga rezultatet e Kosovës. Vetëm përfaqësuesja e Kosovës mbahet me taksat tona. Vetëm ajo mund ta bëjë të valojë fitimtar flamurin tonë. Vetëm falë saj mund të dëgjohet himni i shtetit tonë. Prandaj, si shtet e si shoqëri, qysh sot, duhet të fillojmë të bëjmë plane në atë drejtim. Nëse punohet si duhet, edhe djemtë tanë që luajnë nëpër botë, mund të kthehen me dëshirë në ekipin e vatrës së tyre", shkruan në profilin e tij në Facebook, shkrimtari Milazim Krasniqi.



RAMUSHI SHERRBUDALLË

"Ky Ramushi njëfarë sherrbudalle. Ky e di mirë se Bedri Hamza ka moral dhjetëherë më të lartë se ky vetë dhe se Hashmi e Kadriu, por don me ia nepërkëmbë dinjitetin pse ai ka guximin ta kundërshtojë vendimin e padrejtë të tij për rritjen e rrogave. Dhe kur ministri i financave ta kundërshtonte ty një vendim, ky është problem i madh. Pastaj vazhdon të llogotisë se sa të lartë e ka pasur Bedriu rrogën në bankë, por harron se ai e la rrogën 4000 euro dhe iu bashkua qeverisë me një rrogë tre herë më të vogël e ku tash po refuzon rritjen e dyfishuar të pagës së tij. Kadriu e Hashimi nuk janë as hija e Bedriut. Atyre edhe 10000 euro t'ua bësh rrogën në muaj, nuk e refuzojnë. Pyeteni Blerim Shalën (ka qenë përmes televizionit) se si i ka thënë Hashimi që t'ua rriste pagesat në bisedimet e Vjenës, sepse i dukeshin të vogla. Ato pra ishin pagesa të veçanta, sepse ata njëkohësisht merrnin edhe rrogat për funksionet që mbanin në Kosovë. Të bësh krahasim mes Ramushit, Kadrisë dhe Hashimit ne njëherë anë dhe të Bedri Hamzajt në anën tjetër është si t'i krahasosh një gjarpër, një ujë dhe një dhelprë me një qengj. Problemi është se qengji jeton shumë afër gojës së ujkut dhe duke qenë aq afër është i rrezikuar përherë. Ramushi po punon dhe po komunikon me logjikën dhe gojën e cubit. Kjo logjikë është e huaj për njerëzit që kanë kaluar nëpër dyert e dijes dhe të shkencës, prandaj është e huaj edhe për Bedri Hamzën" ka shkruar mjeku dhe shkrimtari Liri Loshi në profilin e tij në Facebook.



KY MATRAPAZ NUK ËSHTË I VETËM

"Mustafa Nano, i cili nga andej kufiri ka kohë që nxitë, propagandon e shkruan zi për shqiptarët e Kosovës dhe për Kosovën, kohëve të fundit ka filluar edhe haptazi t'i shpallosë ndjenjat dhe qëndrimet e tij armiqësore-patologjike kundër nesh. Ai po provokon në mënyrë të ulëta, ndërsa me emisionin e tij "Provokacija" po i matë pulsën shqiptarëve këndej kufiri. Jam i sigurt se ky matrapaz nuk është i vetëm, por ka të tjerë që i rrinë pas dhe e ndërsejnë. Gjithë këtë, natyrisht, nuk e bënë as si rastësi e as pa ndonjë shpërblim. E pra, i qoftë haram krejt ajo që e ha në emër të kësaj...!", shkruan teologu Mustafa Bajrami, në profilin e tij në Facebook.



MEDIA Citate

TURQIA FITOI MBI 15.9 MILIONË DOLLARË NGA EKSPORTI I MJALTIT

Turqia ka rritur sasinë e eksporteve të mjaltit me 64 për qind nga janari deri në qershor nga viti në vit, një rritje prej 77 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar

Shoqata e Eksportuesve të Detit të Zi (DKIB) ka njoftuar se Turqia fitoi mbi 15.9 milionë dollarë të ardhura nga eksporti i mbi 3.706 ton mjaltë në 33 vende në gjysmën e parë të vitit 2018. Turqia ka rritur sasinë e eksporteve të mjaltit me 64 për qind nga janari deri në qershor nga viti në vit, duke regjistruar një rritje prej 77 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Të dhënat tregojnë se tre blerësit kryesorë të mjaltit turk në këtë periudhë ishin Gjermania, SHBA-të dhe Mbretëria e Arabisë Saudite. Gjermania ishte në vendin e parë me 7.94 milionë dollarë, pasuar nga SHBA-të (3.45 milionë dollarë) dhe Arabia Saudite (936.298 dollarë) Kreu i DKIB-it, Saffet Kalyoncu, për AA tha se rajoni ka treguar interes për mjaltin e gështenjes dhe luleve malore. "Në vitet e fundit, eksportet e mjaltit të Turqisë si një produkt i brenduar kanë filluar të zhvillohen çdo ditë për shkak të avantazheve të ofruara nga flora e pasur dhe diversiteti i bimëve tipike në vendin tonë", theksoi Kalyoncu. Kalyoncu gjithashtu tha se mjalti i Turqisë u eksportua kryesisht në Gjermani, SHBA dhe Arabinë Saudite, ndërkohë që rritja më e madhe e eksporteve u regjistrua në Spanjë dhe Oman. "Eksportet tona vazhdimisht janë në rritje dhe ne besojmë se do të arrijmë në një pikë shumë më të mirë deri në fund të vitit", tha ai. Sipas DKIB-it, Turqia vitin e kaluar fitoi 23.8 milionë dollarë të ardhura nga eksportet e mjaltit në 435 vende.

(Anadolu Agency, 17 korrik)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUR I KA PASUR FILLESAT E TIJ TEATRI NË SHQIPËRI?

Zbulimet arkeologjike që janë bërë në Shqipëri, në Kosovë dhe në tërë trevën ku në kohët e lashta banonin ilirët kanë nxjerrë në dritë godina teatri dhe objekte të tjera si maska, figura aktorësh në terrakota apo vizatime aktorësh në vazo. Teatri e pati origjinën nga lojërat e manifestimet popullore. Në shek.IV-



Dyrrah etj. Amfiteatrot ku jepeshin shfaqje kishin 3000 deri në 7000 vende, një dëshmi se teatri ishte një art mjaft popullor e masiv.

III p.e.s., kur Iliria njohu zhvillimin e saj më të madh, mori përhapje edhe teatri si në qytetet ilire Bylis (Hekal), Nikaia (Klosi), Finiq, Butrot, Sofratikë etj., ashtu edhe në Apoloni,

Zaev shfrytëzoi konferencën e përbashkët për shtyp me komisar Han për t'i dërguar apel Ruisë, e cila siç tha kryeministri, duhet ta dijë se për Maqedoninë nuk ka alternativë tjetër përveç anëtarësimit të plotë në NATO dhe BE

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 17 korrik - Të martën, me vizitën të eurokomisarit për zgjerim dhe politikë fqinjësore, Johannes Han, u hap dhe zyrtarisht procesi i skringut për fillimin e negociatave të Maqedonisë me Bashkimin Evropian. "Ju do të vendosni për të ardhmen e vendit, ndërkaq dyert e BE-së janë të hapura gjerë. I ftoj palët e përfshira që këtë ta pranojnë si qëllim mbipartiak dhe në mënyrë konstruktive të vendosin. Kjo do të sjell dobi reale për popullin. Perspektiva evropiane i përmirëson kushtet për jetesë të qytetarëve dhe ajo është më e rëndësishmja", tha Han, duke shtuar se nëse bojkotohet referendumi, për Maqedoninë do të jetë diçka e ngjashme siç është Brexit për Britaninë e Madhe. Ai uroi qytetarët për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO, ndërkaq edhe njëherë i rikujtoi se me anëtarësimin e vendit në NATO, vendi është më i sigurt. "Dua t'ju uroj për ftesën që e keni marrë javën e kaluar për fillim të negociatave me NATO-n. Qytetarët do të kenë siguri më të lartë. Populli këtu ka treguar qëndrueshmëri dhe shërbimet si shembull për gjithë rajonin, që duhet t'i inkurajojë vendet që kanë probleme bilaterale, t'i zgjidhin", ka thënë Johannes Han. Nga ana tjetër, kryeministri Zoran Zaev theksoi se vitin e ardhshëm, në këtë kohë, do t'i hapim bisedimet për kapitujt e parë për anëtarësim në BE. "Vjet në Bruksel, me eurokomesarin Han dhe përfaqësuesen e lartë të BE-së, Federika Mogherini, jemi marrë vesh për qasje të përbashkët për plotësimin e kushteve për progres në Union. Jemi marrë vesh të tregojmë rezultate, ndërkaq BE na ka dhënë dhuratë përkatëse. Në bazë të suksesit të Planit reformues 3-6-9, Maqedonia ka fituar rekomandim të pakushtëzuar për fillimin e bisedimeve me BE-në. Marrëveshjet që janë nënshkruar me Bullgarinë dhe Greqinë, për Maqedoninë janë suksese historike dhe e kanë hapur rrugën e BE-së", tha Zaev. Njëkohësisht, Zaev shfrytëzoi konferencën e përbashkët për shtyp me Komisar Han për t'i dërguar apel Ruisë, e cila siç tha kryeministri, duhet ta dijë se për Maqedoninë nuk ka alternativë tjetër përveç anëtarësimit të plotë në NATO dhe BE. Zaevi shtoi se edhe më tej qëllim i Maqedonisë është që të

MË VIZITËN E HAN ZYRTARISHT FILLOI KONTROLLI I REFORMAVE

SKRNINGU NIS ME GJYQËSINË DHE SUNDIMIN E LIGJIT



bashkëpunojë me Rusinë. "Ne jemi vend i vogël, na duhen miq, atë e kemi bërë me fqinjët dhe me tërë vendet e botës. Jam i kënaqur që Han dhe ekipi i tij e kanë përkushtuar kohën e tyre për seancën tonë qeveritare", deklaroi Zaevi në lidhje me deklaratat se biznesmenë rus janë përzier në protestat në Maqedoni.

NESËR TAKIMI I LIDERËVE

Kryeministri Zaev njoftoi se për shërbimet kryesor është emëruar Bujar Osmani, njëherësh zëvendëskryeministër për Çështje evropiane. Zëvendës i tij do të jetë këshilltari i veçantë për integritet evropiane në kabinetin e Zaevit, Bojan Mariçiq. Kryeministri gjithashtu tha se do të kërkojë takim liderësh me liderin e opozitës, Hristian Mickoski, me qëllim që, siç tha, të përshpejtohen proceset në prag të referendumit për emrin që duhet të mbahet në vjeshtë.

"Kam informata se shefi i opozitës Hristian Mickoski do të udhëtojë të enjten pasdite. Sot do të kemi konsultime për takim liderësh, i cili me siguri do të mbahet të mërkurën që t'i përshpejtojmë proceset për referendumin", deklaroi Zaev gjatë konferencës së përbashkët për media me eurokomisarin për Zgjerim, Johannes Han. Ndryshe, Han mori fjalën edhe në seancën e Këshillit kombëtar për eurointegritet të martën në Parlament. "Unë ju ftoj që të ndihmoni dhe monitoroni këtë proces shumë afër. Është shumë e rëndësishme të dëshmoni unitet në këtë proces për të arritur qëllimin strategjik për vendin tuaj. Ju keni mundësinë unike për të bërë bashkë zërat e ndryshëm në shoqëri

MAROKO NDALET NË SHKUP

Zëvendës-ndihmës sekretari shtetëror i SHBA-së dhe shefi i Byrosë për konflikte dhe operacione për stabilizim, Pit Maroko, po qëndron në Maqedoni në suaza të turneut të tij nëpër vendet e Ballkanit. Maroko pasdite është takuar me anëtarët e Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie me komunitet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa pritet të bisedojë edhe me përfaqësuesit e Qeverisë. Siç kumtoi Stejt Departamenti, Maroko është për vizitë të Ballkanit Perëndimor me qëllim që ta shprehë angazhimin e vazhduar në rajon si prioritet të lartë të Byrosë. Nismat rajonale për ballafaqim me ekstremizmin e dhunshëm dhe përpjekjet për përfundimin e dialogut ndërfaqësor të Ballkanit Perëndimor do të jenë temat në të cilat Maroko do të bisedojë me përfaqësuesit e autoriteteve të shteteve të cilat do t'i vizitojë. Maroko gjithashtu do të japë edhe mbështetje për anëtarësimin e këtyre vendeve në BE. Krahas Maqedonisë, turneu ballkanik i Pit Marokos i përfshin edhe Serbinë, Kosovën dhe Bosnjën e Hercegovinën.

dhe të bëni ndryshimin. Ju inkurajoj që të qëndroni të fokusuar dhe të bashkuar", tha Han. Ndërsa për deputetin e Parlamentit Evropian, Ivo Vajgël, fillimi i skringut nuk është formalitet, por është rast thelbësor për përparim. "Anëtarësimi në BE dhe NATO janë mundësi historike për Maqedoninë. Nuk do të ketë mundësi të dytë. Dua ta përcjell porosinë deri tek ju se nuk do të ketë mundësi të dytë për të zgjidhur çështjet e hapura që rënduan procesin e qasjes së Maqedonisë drejt BE-së shumë vite pasi morët kandidaturën për anëtarësim. Askush s'mund të

mendojë kushte më të mira për të filluar bisedimet dhe të përfundojnë me sukses negociatat mes Maqedonisë dhe Greqisë", ka thënë Vajgël.

OSMANI: KOHË VENDIMESH ME "V" TË MADHE

Në ndërkohë, zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, tha se procesin e integritet evropiane asnjë person në vend nuk e konteston dhe se meritë për atë që është bërë deri më tani kanë dhe qeveritë e kaluara. "Kjo është kohë vendimesh me "V" të madhe. Bëhet fjalë për vendime

të mëdha historike, strategjike, shtetërore të cilat secili prej nesh do të duhet t'i sjellë sipas bindjeve personale se nuk janë vetëm për ne, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Prej nesh varet nëse do të shkojmë përpara ose do të kthehemi mbrapa. Kjo mundësi e cila është para nesh vjen vetëm një herë dhe nuk guxojmë ta humbasim. Nuk kemi më kohë për të humbur", tha Osmani në seancën në të cilën morën pjesë edhe eurokomisarit për Zgjerim, Johannes Han dhe raportuesi për Maqedoninë në PE, Ivo Vajgël. Ai theksoi se ky nuk është sukses vetëm i kësaj Qeverie, por edhe i të gjitha Qeverive paraprake dhe theksoi se vendi po shkon përpara, pasi, thotë, jemi të vetëdijshëm se vendimet tona janë të rregullta. Theksoi se nuk ka hapësirë për dilema dhe se vendi ka kapacitet për zbatimin e negociatave inkuadruese. "Nuk ka hapësirë për skepticizëm dhe mosbesim pasi ai nuk është i bazuar. Po, ne mundemi. Mund të arrijmë rezultate. Nuk ka bazë të mos besojmë në vete se këtë proces mund ta kalojmë me sukses. Momenti është tani, ndërsa përgjegjësia është e jona. Na pret punë e madhe, së bashku jemi më të fuqishëm", porositi Osmani. Për Nikolla Popovskin, deputet i VMRO-DPMNE, me rëndësi janë edhe ndryshimet e mendësisë në raportet pushtet-opozitë kur janë në pyetje eurointegritet. "Neve na nevojitet ndryshim i mendësisë. Argumenti kryesor i pushtetit është se edhe ata më parë kanë vepruar njëjtë. Kjo duhet të marrë fund. Përgjegjësi mbajnë edhe pushteti edhe opozita. Opozita duhet të ofrojë zgjidhje dhe jo vetëm të rrijë. Gjashtë muaj duhet vetë të bëjmë skringun me kapacitetin e institucioneve tona. Bashkë të ulen pushteti dhe opozita dhe ta ndryshojnë mentalitetin", theksoi Popovski. Paraprakisht, komisar Johannes Han pati takim me kryeparlamentarin Talat Xhaferi.

OSE RATIFIKIM ME 180 DEPUTETË, OSE REFERENDUM

Pozicioni ynë është i qartë dhe përfshin dy punë ose 180 deputetë ose populli, thotë nënkryetari i Greqëve të pavarur, Panajot Zguridis, lidhur me ratifikimin në Parlamentin grek të Marrëveshjes nga Prespa. Në intervistë për radion greke "Real Fm" ai e përsëritë pozicionin e partnerit të koalicionit në Qeverinë greke se zgjidhja mes Maqedonisë dhe Greqisë duhet të votohet me shumicë të madhe (180, në vend të 151 deputetëve), ndërsa në të kundërtën, ata do të tërhiqen nga qeveria. Zguridis id emanton edhe

informatat se Marrëveshja do të merrte votë edhe nga disa nga deputetët e Greqëve të Pavarur. "Nuk do të ketë deputetë nga Greqët e Pavarur të cilët do të votojnë për Marrëveshjen", thotë Zguridis. I pyetur lidhur me informatat se ka pasur, nga faktorë rusë, tentim për mito për pjesëmarrje në protestat në Greqinë veriore, Zguridis thotë se "nuk duhet dikush të paguajë që Greqët të Pavarur ta ruajnë pozicionin që e kanë prej fillimit", lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina.

QEVERIA PRESION OPOZITËS

KSHZ MUND TË ZGJIDHET EDHE PA DY TË TRETAT

Ndryshimet ligjore janë propozuar pak përpara se të niste seanca parlamentare duke shkaktuar tension në radhët e opozitës e cila ka kërkuar shtyrjen e seancës. Ndryshimet do të mundësojnë zgjedhjen e anëtarëve të rinj me shumicë parlamentare, që do të thotë me 61 vota dhe jo me dy të tretat e votave, formë kjo që do të zhbllokojë situatën e krijuar në Komisionit e zgjedhjeve dhe emërimeve ku prej një kohe të gjatë mbajtja e seancave shtyhet

Koha Evis HALILI

Shkup, 17 korrik – Propozimi i Qeverisë, që “dy të tretat” do të eliminohet nga Kodi Zgjedhor gjatë votimit të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke u zëvendësuar me shumicë absolute, është miratuar në seancën e sotme të Parlamentit. Duke hapur kështu rrugë shqyrtimit të këtyre ndryshimeve ligjore nëpër komisioneve parlamentare përpara votimit final në Parlament. Ndryshimet janë propozuar pak përpara se të niste seanca e sotme parlamen-



tare duke shkaktuar tension në radhët e opozitës e cila ka kërkuar shtyrjen e seancës. Ndryshimet e propozuara do të mundësojnë zgjedhjen e anëtarëve të rinj me shumicë parlamentare, që do të thotë me 61 vota dhe jo me dy të tretat e votave, formë kjo që do të zhbllokojë situatën e krijuar në Komisionit e zgjedhjeve dhe emërimeve ku prej një kohe të gjatë mbajtja e seancave është shtyrë. Opozita e cila prej disa kohësh bojkoton procesin e formimit të KSHZ është kapur në befasi nga kjo formë presioni që vjen direkt nga Qeveria. VMRO-DPMNE e ka cilësuar këtë veprim të Qeverisë si antidemokratik dhe pa asnjë vlerë evropiane. Madje deputeti Dragan Danev, koordinatori i grupit parlamentar ka thënë se Qeveria është duke injoruar inteligjencën e qytetarëve.

“Në Maqedoni nuk ka ndodhur asnjëherë që të ndryshohet Kodi

Zgjedhor pa mbështetjen e opozitës. Ju e shkelët praktikën demokratike, pritët zotin Han dhe sa e përcollët atë menjëherë dorëzuar këto propozim ndryshime”, ka thënë Danev. VMRO ka kërkuar një orë pauzë në seancë plenare. Sipas këtyre ndryshimeve, përveç se propozohet që të ndryshohet shumica e nevojshme për formimin e KSHZ, por Qeveria ka kërkuar që ato të miratohen me procedurë të përsheptuar, por edhe propozon një

mënyrë të re për kandidimin e anëtarëve të KSHZ. Përkatësisht Qeveria sugjeron që nga Kodi Zgjedhor të hiqet pika sipas të cilës e drejta e formimit të listës me emrat e kandidatëve të propozuar i takon Komisionit të zgjedhjeve dhe emërimeve. Në vend të saj lista me emrat të propozohet direkt në seancë parlamentare. Në propozim ndryshimet e Qeverisë po ashtu saktësohet që gjatë seancës plenare opozita duhet që të propozojë

kryetarin dhe dy anëtarë të KSHZ, ndërsa Qeveria zëvendëskryetarin dhe tre anëtarë të KSHZ.

Kjo është java e fundit ku duhet të zgjidhet përfundimisht çështja për formimin e KSHZ, për shkak të aktivitetit të këtij organi që duhet të merret me përgatitjen e referendumit. Çdo vonesë do të sillte edhe shtyrjen e afateve të parashikuara për zhvillimin e referendumit, për në fund të muajit shtator. Zgjidhja e anëtarëve të KSHZ ka skaduar më 29 qershor, ndërsa KSHZ duhet t'i bëjë të gjitha përgatitjet për referendumin, që është një prej detyrave që del nga Marrëveshja për zgjedhjen e çështjes së emrit dhe partneritetit strategjik me Greqinë, por edhe pjesë e procedurave të brendshme që duhet të zbatohen para anëtarësimit të plotë të vendit në NATO. VMRO-DPMNE gjatë kësaj periudhe ka bojkotuar këtë proces duke kërkuar që kjo çështje të trajtohej se bashku me paketën e reformave, miratimi i Ligjit për financimin e partive politike, ku duhet të definohen të njëjtat kushte që i kishte opozita në kohën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016.

NDRYSHIMET, NGA DY TË TRETA NË SHUMICË ABSOLUTE

Në ndryshimet të cilat i ka propozuar Qeveria kërkohet që në Kodin Zgjedhor, në nenin 27 të fshihet paragrafi 3 dhe togfjalëshi “në propozimin e listës” të fshihen. Po ashtu edhe “dy të tretat” fshihet. Ligji do të hyjë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën zyrtare. “Kushtetuta e përcakton shumicën e nevojshme për miratimin e vendimeve, që varion sipas materies ligjore ose pozicionit të zgjedhur apo të emëruar për të cilin miratohet vendimi. Qëllimi i këtyre mekanizmave dhe sidomos i shumicës prej dy të tretave gjatë miratimit të vendimeve është që të sigurohet një legjitimitet më i

gjerë dhe inkluzivitet i të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Parlament. Përveç këtyre zgjedhjeve kushtetuese ligje të caktuara parashikojnë dy të treta për zgjedhjen e anëtarëve të trupave, në rastin konkret të atyre të KSHZ. Gjithsesi që një zgjidhje e tillë megjithë qëllimin e mirë gjatë hartimit të tij nuk duhet që të shndërrohet në të kundërtën e vet, duke i mundësuar opozitës parlamentare që të bllokojë tërësisht procesin e miratimit të vendimeve, konkretisht zgjedhjen e nënkryetarit dhe anëtarëve të KSHZ”, shkruhet në propozim ndryshimet e Qeverisë.

BORISOV FLET PËR MAQEDONINË DHE SHQIPËRINË

Afrimi në BE, arritja më a madhe e presidencës bullgare

“Ndryshimet në Ballkan duhet të tejkalohen me dialog dhe se traktati i fqinjësisë së mirë, midis Bullgarisë dhe Maqedonisë është një model për këtë. Një pasojë e kësaj ishte se në fund të qershorit, Këshilli vendosi një afat që mundësoi hapjen e bisedimeve të pranimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë”, ka thënë Borisov



Sofje, 17 korrik – Theksi mbi perspektivat europiane të Ballkanit Perëndimor, ishte arritja e nënshkrimeve të Presidencës së parë bullgare të Këshillit të BE, sipas kryeministrit bullgar Bojko Borisov, i cili përmbodhi gjysmën e parë të vitit 2018 në Parlamentin e vendit.

“Ne kemi qenë në gjendje ta nxjerrim këtë çështje nga kontek-

shorit, Këshilli vendosi një afat që mundësoi hapjen e bisedimeve të pranimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë”.

Ministrja e Jashtme, Ekaterina Zaharieva tha në vërejtjet e saj për legjislaturën se Bullgaria, “ishte në gjendje të zhbllokonte perspektivën europiane të Ballkanit Perëndimor” dhe të gjithë liderët e shteteve anëtare të BE-së dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor pajtohen me këtë përfundim. Ministri i Mbrojtjes, Krasimir Karakachanov, tha se “ambicia më e madhe e Bullgarisë është të shohë përparim në afrimin e Ballkanit Perëndimor me BE-më dhe NATO dhe se kjo është arritur - diçka që të gjitha partitë, duke përfshirë vetë Ballkanin Perëndimor, e pranojnë”. Kryeministri veçoi përmbushjen e mbrojtjes së kufirit të BE-së, të cilin ai tha ishte një detyrë e vështirë. Ai

nënvizoi rolin e dialogut me Turqinë për trajtimin e çështjes së emigrantëve. “Ne arritëm të bashkohemi me partnerët tanë evropianë për të vazhduar dialogun me Turqinë”, tha Borisov.

Për kryeministrin, presidenca ishte “një shans historik që Bullgaria nuk duhet të humbasë, duke rikonfirmuar besimin e fituar midis të gjithë partnerëve evropianë dhe vendeve fqinje me të gjithë qytetarët e tyre” dhe “një test i identitetit tonë evropian gjatë të cilit, ne treguam që i kuptojmë prioritetet europiane dhe mund të punojmë me përkushtim për realizimin e tyre”. Mustafa Karadayi, kreu i Lëvizjes për të Drejtësi dhe Liri (MRF), tha se ndërsa ata pajtohen me vlerësimet pozitive, gjatë muajt e presidencës ishte një kohë e shpërfilljes për problemet e brendshme të vendit.

ZHVILLIMI I TREGUT TË KAPITALIT

“FINANCIMI GRUPOR”, PA TRADITË NË MAQEDONI

Për ekspertët ekonomik zbatimi i këtij koncepti është vështirë të funksionin në Maqedoni sepse këtë koncept me sukses e zhvillojnë vendet të cilët janë pjesë e BE-së ndërsa Maqedonia ende nuk është pjesë e vendeve të BE-së dhe nuk ka traditë të investimeve të këtij lloji koncepti ku pothuajse gjithçka bëhet në formë elektronike



mundëson në funksionalizimin më të madh të mjeteve dhe futjen e tyre në ekonominë reale e jo vetëm të kemi kursime në banka”, thotë Milaim Ameti nga OEMVP-ja. Edhe pse ky koncept me sukses funksionon në shumë vende të botës, Ameti thotë se për ekonominë e vendit do të jetë një koncept sfidues sepse Maqedonia nuk ka traditë të investimeve të këtij lloji ku pothuajse gjithçka bëhet në formë elektronike. “Por sigurisht që duhet të punohet në këtë fushë me qëllim të nxitjes së investimeve përmes formave më bashkëkohore të platformave të këtitilla, sepse këtu ka qasje çdo qytetar dhe sigurisht që do të mund të kemi motiv më të madh për sipërmarrësit e rinj që ata të krijojnë veprimtari në vend dhe të ngelen këtu por edhe nga ana tjetër do të kemi zhvillim më të madh të vendit”, thotë Ameti. Nga OEMVP-ja thotë Ameti do të përket çdo që iniciativë qeveritare që ka të bënë me shtimin e instrumenteve ose platformave të reja të financimit me të vetmin qëllim që qarkullimi i parave të jetë më i lartë në ekonominë reale sepse këtu do mundëson që me të njëjtin fond të parave të kenë leverdi më të madhe të gjithë si investuesit ashtu edhe shtetit duke marrë parasysh tatimet që dalin nga çdo transakcion i mjeteve tyre.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 17 korrik - Këshilli për zhvillim të tregut të kapitalit pranë Ministrisë së Financave ka diskutuar të hënën për zbatimin e konceptit “Kroudfunding” apo “Financimit grupor” në Maqedoni, gjegjësisht konceptit për grumbullimin e mjeteve nga një numër më i madh i investitorëve për financimin e kompanive dhe qasjen më të lehtë deri të kapitali nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e në veçanti kompanitë e reja të sapo formuara.

Këshilli në fjalë i kryesuar nga

ministri i Financave, Dragan Tevdovski, guvernatorja e Bankës Popullore, Anita Angelovska-Bezhoska, ministrja për Punë dhe Politikë sociale, Mila Carovska, ajo pa resor Zorica Apostoloska, ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi dhe të tjerë, kanë konstatuar se mundësia për vendosjen e kësaj mënyre për financim në Maqedoni tanimë është i mundshëm, ndërsa si shembull të suksesshëm e kanë marrë konceptin “Kroudfunding” i cili po zhvillohet në vendet e rajonit, si ajo në Kroaci, e cila përmes Platformës Estoneze, me sukses mbledh mjete për investime në projekte dhe

ndihmon kompanitë e vogla dhe të mesme të cilat kërkojnë mjete. “E vetmja mënyrë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të kenë qasje deri te ky fond, i cili do të menaxhohet përmes kanaleve bankare, është të kenë të regjistruar kompani”, thuhet nga Këshilli për zhvillim të tregut të kapitalit. Për ekspertët ekonomik, zbatimi i këtij koncepti është vështirë të funksionoj në Maqedoni, sepse këtë koncept me sukses e zhvillojnë vendet të cilët janë pjesë e BE-së, ndërsa Maqedonia ende nuk është pjesë e vendeve të BE-së. Nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndi-

more (OEMVP) thonë se zbatimi i “Kroudfunding” paraqet një koncept të ri të financimit për vendin tonë edhe pse i njëjti është mjaft atraktiv dhe i njohur në vendet tjera dhe se ky koncept i ri do të zgjerojë gamën e instrumenteve financiare për financim të projekteve pasi që në Maqedoni njëri prej problemeve kryesore në funksionimit të bizneseve të vogla dhe të mesme është qasja në financa. “Rrjedhimisht nëpërmjet kësaj platforme mundësohen që të grumbullohen mjete financiare pothuajse nga çdo qytetar me shumë të ulta gjë që do të

RENOVIMI I SHKUPIT TË VJETËR

Filloi restaurimi i Çifte Hamamit

Rinovimi i objekteve historike në Çarshinë e Shkupit çdoherë është përshëndetur nga esnafit dhe qytetarët të cilët shpirtërisht janë të lidhur me këtë trashëgimi. Megjithatë, ata nënvizojnë se pjesa e vjetër e Shkupit ka nevojë më tepër për investimet shtetërore në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë nga koha e Perandorisë Osmane, pasi jo çdo shoqëri posedon një pasuri të tillë

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 17 korrik - Çifte Hamami, një objekt i lashtë historik që nga koha e Perandorisë Osmane, i pozicionuar në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, gjatë dy muajve të ardhshme do ti nënshtrohet një procesit të restaurimit. Punimet të cilat kanë

filluar disa ditë me radhë i kanë sqaruar edhe nga Galeria Kombëtare e Maqedonisë, ku theksojnë se pas Çifte Hamamit, restaurimit do ti nënshtrohet edhe Hamami i Daut Pashës, i cili gjendet në hyrje të Çarshisë, nga pjesa e Urës së Gurit. Kjo ndërhyrje institucionale në objektin e Çifte Hamamit, sipas arkitektit Lllazar Shumanov, synon rimëkëmbjen e dëmeve nga lagështia e brendshme dhe e jashtme, mbrojtjen kundër ujërave atmosferike, futjen e sistemit të ventilimit të brendshëm, mbrojtjen nga rrezatimi UV e kështu me radhë.

“Në këtë fazë do të kryhen aktivitetet sikur që është riparimi i çatisë me ndërtimin e kanaleve horizontale edhe vertikale për mbrojtje nga ujërat atmosferike, ndërtimi i një kanali kullues në anën lindore të ndërtesës (eksterier), riparimi i të gjitha dëmeve nga lagështia e brendshme (depo, hapësira ekspozuese) me një sfond të veçantë me panele për gjatë murit perëndimor. Tutje restaurimi ka për qëllim shndërrimin e objekteve në hapësira ekspozuese funksionale me kontakt vizual, me hipoakustik dhe zhvendosjen e dhomës së por-

tierit, respektivisht rinovimi i ‘Çifte Hamamit’ bëhet edhe në drejtim të ndërtimit të një strukture mbrojtëse të çatisë në pjesën e jashtme lindore mbi vatrën e zjarrit”, thonë nga Galeria Kombëtare e Maqedonisë.

Fillimi i punimeve përreth Çifte Hamamit është mirëpritur nga shumë esnaf, të cilët vlerësojnë se mbështetja institucionale ndaj kësaj kategori të objekteve historike nuk duhet të përfundojë me kaq. Nevojën e madhe për riparimin dhe vendosjen në funksion të një sërë objektiv historike në Çarshinë e Shkupit, të cilët për momentin janë në gjendje të mjerueshme e ka potencuar gati çdo dyqanxhi i çarshisë. Kthimi i pamjeve autentike të dyqaneve, gjegjësisht vendosja e fasadave të reja dhe restaurimi i një pjesë të kalldrimit, siç thonë disa dyqanxhi të Çarshisë, në masë të madhe do të ndikonte që turistët e huaj dhe ato vendas t’ia mësyn Shkupi të vjetër më shpesh.

Pa dyshim, njëri prej objekteve që duhet të relativizohet dhe ndërtohet në pamjen e mëhershëm është Shengjyl Hamami, i cili ba-



shkë me Kurshumli Hanin dhe xhaminë e rrënuar të Kazanxhilerëve e ka përbërë një pjesë tejet të rëndësishme të Çarshisë së Shkupit. Paralelisht me Shengjyl Hamamin i cili për momentin pothuajse tërësisht është i rrënuar, me përjashtim të një murri të vjetër i cili ndër vite qëndron si një lule e venitur që pret të ujitet, restaurimi i urgjent duhet të bëhet edhe mbi gjitha muret e Kurshumli Hanit. Jo larg Çarshisë, por në një lagje të vjetër të Shkupit, nën Sahat Kullën e njohur, qëndron edhe një hamam tjetri i cili në popull njihet si “Banja e re”. Ndërtimi i kompleksit universitar

të “Shën Kirilit dhe Metodit” nga njëra anë dhe urbanizmi i mëhullës së Sahat Kullës, nga ana tjetër fatkeqësisht e kanë lënë nën hije këtë objekt të rëndësishëm kulturor. Sidoqoftë, punime si ky llojit të restaurimit të Çifte Hamamit, ngjallin shpresë të shumë qytetarë të pjesës së vjetër të Shkupit dhe kryesisht Çarshisë, se në kuadër të institucioneve shtetërore ekzistojnë njerëz me logjikë të shëndosh, të cilët dinë të bëjnë dallimin mes peshës që kanë objektet vjetra historike të lëna pas dore dhe ato të cilat u ndërtojnë në kuadër të projektit famëkeq “Shkupi 2014”.

“Komitët” njihen për lidhjet e tyre me politikën, posaçërisht me VMRO-DPMNE opozitare, ndërsa edhe më herët janë shfrytëzuar për të iniciuar dhunë të motivuar politikisht. Klubi i futbollit Vardar është pronë e milionerit rus Sergej Samsonenko, i cili, ashtu sikurse Sividi, ka jetuar në qytetin rus Rostov. Tani ai jeton në Shkup dhe është konsull nderi i Rusisë në Manastir

Shkup, 17 korrik - Kryeministri i Maqedonisë ka akuzuar “biznesmenët grek” mbështetës të interesave të Rusisë për nxitje të trazirave në vend për shkak të ndryshimit të propozuar të emrit, të cilët do të pamundësonin hyrjen në NATO. Dokumentet nga Ministria e Punëve të Brendshme, në të cilat qasje kishin gazetarët e Laboratorit hulumtues të Maqedonisë, partner i Projektit për informim për krimin e organizuar dhe korrupsionit (OC-CRP), kanë zbuluar se paku një burim përmes së cilit është bërë pagesa. Kundërshtarëve të riemërimit, u janë paguar së paku 300.000 euro nga ana e Ivan Sividi, miliarderi rus, i cili jeton në Greqi dhe i cili më herët ka qenë anëtar i parlamentit rus.

Këto pagesa janë bërë përmes dhjetëra politikane maqedonase nga parti të ndryshme, anëtarë të organizatave të nacionaliste radikale të formuara kohëve të fundit dhe huliganëve tifoze të kubit të Vardarit të cilët morën pjesë në

PËRFSHIRJA E RUSISË NË POLITIKAT E BRENDSHME

SAVIDI, NXITËS I TRAZIRAVE NË MAQEDONI



trazirat e fundit. Javën e kaluar, Greqia dëboi dy diplomatë rus të cilët paguanin kundërshtarët e marrëveshjes për emrin dhe kanë nxitur mitingje kundër marrëveshjes. Gjithashtu, dy diplomatëve të tjerë rus u ka ndaluar hyrjen në vend.

Moska ka mohuar këto pohime dhe ka dënuar veprimin e Athinës si të pabazë. Zëdhënësjja e Departamentit Amerikan të Shtetit, Heder Naurt, ka shkruar në twitter se SHBA mbështetin Greqinë në mbrojtjen e sovranitetit të saj. “Rusia duhet t’i jep fund sjelljes së saj destabilizuese”, ka shkruar Naurt. Sipas dokumenteve tek të cilat kanë patur qasje gazetarët, Sividi

ka transferuar paratë në Maqedoni me sërë pagesash. Një pjesë e parave janë transferuar kesh dhe kanë kaluar kufirin në duke dhënë paratë në dorë. Madje janë përdorë edhe metoda të tjera. Burimet policore, që kanë kërkuar të mbeten anonim, thonë se hetimet për transferin janë në vijim, së bashku me një hetim të posaçëm për bizneset të cilat do të mundnin të rrezikonin paqen dhe sigurinë në rajon.

Sividi, i lindur në Gjeorgji, i njohur si Savidis, pasurinë e tij e ka bërë përmes privatizimit të të asaj që më vonë të bëhet kompania më e madhe ruse e duhanit. Ai është njëri ndër biznesmenët më të pasur në Rusi, me pasuri prej rreth 2

miliard dollarë amerikan. Pasi u shpërngul në Greqi, ka mes i viteve 2000, ka blerë Klubin e futbollit PAOK dhe media të ndryshme, ndërsa perandoria e tij e biznesit është më e zhvilluar në Selanik.

Gazetarët për “Investigative Reporting Lab” kanë vërtetuar transferet e biznesmenëve me disa nga pranuesit. Një pjesë e personave që kanë pranuar para kanë pohuar transferet kanë qenë një grup i huliganëve të futbollit që kanë lidhje me Komitetin, fan-klubi i ekipit të futbollit Vardar. Personat e njëjtë kanë marrë pjesë në protestat e dhunshme në Shkup, ndërsa dhjetë prej tyre janë arrestuar. Njëri prej huliganëve

ve ka pohuar se grupi ka pranuar para nga Sividi. Dokumentet gjithashtu tregojnë se disa anëtarë të grupit nuk kanë pranuar të marrin para.

“Komitët” njihen për lidhjet e tyre me politikën, posaçërisht me VMRO-DPMNE opozitare, ndërsa edhe më herët janë shfrytëzuar për të iniciuar dhunë të motivuar politikisht. Klubi i futbollit Vardar është pronë e milionerit rus Sergej Samsonenko, i cili, ashtu sikurse Sividi, ka jetuar në qytetin rus Rostov. Tani ai jeton në Shkup dhe është konsull nderi i Rusisë në Manastir.

Ish kreut të Komitëve, Aleksandar “Zhuti” Kolevski vikendin e kaluar i është ndaluar hyrje në Greqi si persona non grata që paraqet “rrezik për paqen dhe sigurinë publike”, sigurinë e brendshme si dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të Greqisë.. Gjatë bisedës me gazetarët e “Reporting Lab Macedonia” Kolevski ka thënë: “Unë nuk jam rrezik për sigurinë. Çdo gjë që bëj është për dashurinë ndaj vendit. Nuk kam marrë para. Unë jam një fans i thjeshtë i Vardarit”. Sividi për momentin nuk ka dhënë asnjë përgjigje për gazetarët në lidhje me tekstin e publikuar. Hetimet policore janë në proces. / BuzzFeed News

RIKUALIFIKOHET VEPRA PËR VRASJEN E TË RIUT MAQEDON

MINIMUM 10 VITE BURG PËR VRASËSIT E SAZDOVSKIT

Pavarësisht faktit se vrasja e të riut Nikolla Sazdovski u dënuan nga i gjithë opinion, rryma të caktuara politike nuk pushuan dhe u munduan që kësaj ngjarje tragjike ti japin karakter etnike. Si rezultat i presioni dhe kërkesave të mëdha për drejtësi Prokuroria e Shkupit e rikualifikoi veprën në “vrasje në mënyrë mizore”



dovski, do të akuzohen për veprën penale “vrasje në mënyrë mizore”. Edhe pse fillimisht u tha se të dyshuarit për vrasjen e Sazdovskit do të ngarkohen për veprën penale “dhunë”, Prokuroria e Shkupit ka njoftuar se pas shqyrtimit të dëshmiave dhe provave plotësuese është vendosur rikualifikimi i veprës.

“Pas ndërmarrjes së të gjitha veprimeve për vërtetimin e fakteve

në lëndën prokuroriale kundër të dyshuarve për vrasjen e Nikolla Sazdovskit, ne si prokurori vendosëm rikualifikimin e veprës e cila deri më tani hetoi në procedurë paraprake. Kështu që në vend të veprës penale “dhunë”, ata do të hetohen në bazë të neni 123 paragrafi 1, pika 1 e Kodit Penale të Maqedonisë”, thuhet në kumtesën e Prokurorisë së Shkupit. Dispozitat

e nenit në fjalë parashohin që dënimi më i vogël të jetë minimum dhjetë vite heqje liri deri në burg të përjetshëm. Duke e arsytuar këtë vendim, nga Prokuroria e Shkupit kanë thënë se gjatë procedurës para hetimore janë zhvilluar biseda me shumë dëshmitar, janë siguruar gjithashtu dëshmi material dhe verbale, respektivisht është siguruar protokollin e obduksionit i kryer mbi Sazdovski nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

“Kjo ekspertizë deri te prokuroria është dorëzuar me 16 korrik dhe faktet që burojnë nga ky raport janë të pakontestueshme rreth dinamikës së ngjarjes juridiko-penale, në aspekt të llojit dhe karakterit të lëndimeve që i ka marrë tashmë i ndjeri Sazdovski. Ndërkohë është vërtetuar edhe arsye kryesore që ka ndikuar mbi fatalitetin e të ndjerit”, theksojnë nga Prokuroria e Shkupit.

Krahas ekspertizës së të ndje-

rit, nga prokuroria njoftojnë se në periudhën që vijon do të kryejnë ekspertizë psikiatrit edhe mbi të dyshuarit S.D dhe B.B, të cilët për momentin qëndrojnë në paraburgim. Përderisa për të dyshuarit J.L (19), nga Prokuroria e Shkupit kanë njoftuar se do të lëshojnë flet arrest kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndryshe, vdekja e Sazdovskit, 19 vjeçar ndodhi gati dhjetë ditë pasi i njëjti u sulmua në lagjen Autokomandë të Shkupit, gjatë kohës kur kishte shëtitur me të dashurën e tij.

Deri më tani në opinion është spekuluar shumë për motivin e vrasjes, me çka përmendet se zënka mes të rinjve ka lindur si shkak i ofendimeve në rrjetet sociale apo mos durimit i rivaliteti mes tifo-grupeve “Komitët” dhe “Shvercerat”, gjegjësisht këta të fundit i kanë dëmtuar të gjitha zërat se kanë lidhje me ngjarjen.

Gjithsej 36 kompani, ku shteti apo komunat paraqiten si themelues dhe pronar, kanë treguar humbje, ndërsa fitim kanë treguar 86 kompani shtetërore. Ndër kompanitë që punojnë më dobët, shumica kanë punuar me humbje edhe vitet e kaluara, ndërsa një pjesë e tyre kanë zvogëluar humbjet në vitin e kaluar

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 korrik - Një e treta e kompanive shtetërore në Maqedoni vitin e kaluar kanë punuar me humbje. Sipas analizës së Qendrës për komunikime qytetare, të bazuar në rezultatet financiare të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, në 2017 - 114 ndërmarrje me pronar shtetin, kanë shënuar humbje prej 30 milionë euro përkundër fitimit prej 141 milionë euro. Krahasimi i të dhënave më tej tregon se këto kompani, në vitin 2016 kaluar kanë treguar humbje prej 35.4 milionë euro, që do të thotë zbutje prej pesë milionë e gjysmë të minusit negativ, apo me fjalë tjera është ulur bilanci negativ i punës së tyre në vitin 2017 në raport me vitin paraprak.

Njëherësh, 36 kompani, ku shteti apo komunat paraqiten si themelues dhe pronar, kanë treguar humbje, ndërsa fitim kanë treguar 86 kompani shtetërore. Ndër kompanitë që punojnë më dobët, shumica kanë punuar me humbje edhe vitet e kaluara, ndërsa një pjesë e tyre kanë zvogëluar humbjet në vitin e kaluar. Ekonomistët thonë se jo çdoherë për kompanitë shtetërore vlen rregulli si për kompanitë e tjera në sektorin privat, se rezultatet financiare të një kompanie janë treguesi kryesor për suksesin e tyre, për shkak se shpesh për reformat e nevojshme në punën e tyre mun-

ANALIZË E QENDRËS PËR KOMUNIKIME QYTETARE

KOMPANITË SHTETËRORE, NJË E TRETA PUNON ME HUMBJE



gon vullneti politik nga lartë.

Gjithashtu, ato shpesh ballafaqohen me mungesë investimesh, pajisje të vjetruar, borxhe të akumuluar ndër vite, kryerjen e punëve me interes publik për shkak të së cilave shpesh tregojnë humbje apo edhe mbi-punësim, ku shpesh për numrin e tepërt të punëtorëve dhe lëshimin e tyre eventual nga puna më shumë rëndësi ka momenti social dhe politik se sa ai ekonomik.

Në ndërkohë në, dy vendet e para të renditjes së kompanive që kanë punuar me humbje, janë ato të sektorit të hekurudhave si rrjedhojë e humbjeve të akumuluar edhe nga vitet e kaluara që vijjnë edhe si rrjedhojë e bllokadës totale të transportit hekurudhor për shkak të grevës së hekurudhave greke dhe portit të Selanikut, si dhe harxhimeve të amortizimit. Listën e kryeson ndërmarrja Hekurudhat e Maqedonisë - Transporti me 8.2 milionë euro humbje, e cila megjithatë ka zvogëluar humbjet në raport me vitin paraprak për 27 për qind. Humbjet e

ndërmarrjes Hekurudhat e Maqedonisë - Infrastruktura janë 7.2 milionë euro, që janë zvogëluar për 10.3 për qind në raport me një vit më parë. Në vendin e tretë është ndërmarrja "Strezhevo" nga Manastiri me humbje prej 3.7 milionë euro dhe "Posta e Maqedonisë" që pas disa vitesh me profit modest, në vitin e kaluar shënon humbje prej 3 milionë euro. Me humbje prej 1.9 milion euro punon edhe Aeroportet e Maqedonisë, si dhe ndërmarrjet komunale "Proakva" në Strugë me 950 mijë euro dhe ndërmarrja komunale në Tetovë me humbje prej 770 mijë euro. Pason ndërmarrja "Lisiçe" nga Velesi me 600 mijë euro, Qendra Tregtare në Shkup me 550 mijë euro dhe ndërmarrja e ndërtimit të ulët nga Manastiri me 530 mijë euro minus. Pas publikimit të kompanive që kanë punuar me humbje, është interesante të theksohen edhe ato që kanë punuar me fitim në vitin 2017. Fitim më të madh në vitin e kaluar ka realizuar Ndërmarrja publike për

rrugët shtetërore me 84.2 milionë euro. Kjo shumë është për dy herë e gjysmë më e madhe në raport me fitimin e vitit të kaluar. Analizat më tej tregojnë se suksesi i kësaj kompanie kryesisht vjen si rezultat i shfaqjes para-kontabiliste të të ardhurave më të mëdha financiare, si rrjedhojë e dallimeve pozitive të kursit gjatë vitit të kaluar që i falënderohet kredisë së marrë në dollarë nga kompania kineze për ndërtimin e autostradave. Ky fakt nuk nënkupton se ndërmarrja edhe i ka realizuar këto të ardhura në llogarinë e saj, e aq më pak se edhe realisht disponon me këto të ardhura në llogarinë e saj. Të ardhura prej 18.8 milionë euro apo fitim më të madh me 35 herë më shumë se në vitin 2016 ka shënuar edhe ndërmarrja shtetërore e Lotarisë së Maqedonisë. Kompania shtetërore e përcimit dhe transmetimit të rrymës "Mepso" ka treguar fitim prej 11.3 milionë euro që është për katër herë e gjysmë më shumë se në vitin paraprak. Kompania e prodhimit të energjisë elek-

trike "Elektranat e Maqedonisë" shënoi fitim prej 8.6 milionë euro, apo 37 për qind më pak se në vitin 2016. Me fitim prej 3 milionë euro dallohet edhe ndërmarrja "Zletovica" apo kompania e hidro sistemit për vaditje me fitim prej 3 milionë euro. Ajo më në fund i ka tejkaluar vështirësitë financiare dhe humbjet që ka treguar në vitet 2015 dhe 2016. Këto pesë kompani në fakt krijojnë bile 90 për qind të fitimit të të gjithë kompanive në sektorin publik.

Në top dhjetëshin e kompanive të shtetit me më shumë fitime, renditen edhe ato të Ndërtimit dhe ekonomizimit me hapësirë bane-sore dhe afariste me profit prej 2.1 milionë euro, Ujësjellësi dhe Kanalizimi në Shkup me 1.7 milion euro, apo 22 herë më shumë se në vitin paraprak dhe Higjiena Komunale në Shkup me 1.3 milion euro profit. Me fitim në vitin e kaluar, me profit kanë punuar edhe Ndërmarrja e Rrugëve të Qytetit të Shkupit me 1.2 milion euro apo 79 herë më shumë se në vitin 2016 dhe Pyjet e Maqedonisë me profit prej 1.1 milion euro apo 32 herë më shumë se në vitin paraprak.

Ndryshe, analiza e Qendrës për komunikime qytetare i përfshin të gjitha ndërmarrjet në pronësi shtetërore si ato publike apo shoqata aksionare të themeluara nga Qeveria apo komunat si dhe Qytetit i Shkupit e që kanë dorëzuar llogari përfundimtare deri te Regjistri qendror. Analiza ka përfshirë 118 kompani në pronësi të shtetit sipas të ardhurave apo të dalave dhe të hyrave të tyre.

Nuk mund të sigurohen 27 milionë kg duhan!

Shkup, 17 korrik - Prodhuesit e duhanit nuk e ndajnë vlerësimin me Odën Ekonomike të Maqedonisë se çmimi blerës i duhanit sivjet do të jetë më i ulët, por janë të mendimit se kushtet jo të volitshme të motit reflektojnë ndaj cilësisë për çka është e pasigurt nëse do të porositen 27 milionë kilogramë shtesë, aq sa kërkojnë blerësit. "Nuk besoj se do të ketë çmim më të ulët blerës sepse tani mblidhet pjesa e fundit e duhanit. Vjet edhe ato nuk ishin me cilësi të mirë. Presim në periudhën e ardhshme kushtet e motit të jenë të volitshme dhe të kemi cilësi sikur vjet. Nga ana tjetër, është e saktë se sasi të janë zvogëluar. Kompanitë kërkojnë rreth 27 milionë kilogram duhan, sasi për të cilat ar-

ritëm edhe marrëveshje, por pas motit të ligë, pikëpyetje është nëse do të ketë maksimum 20 milionë kilogram", thotë për MIA-n kryetari i Lidhjes së shoqatave të prodhuesve të duhanit të Maqedonisë, Kire Nedelkovski. Për rekoltën 2018 janë arritur 34.105 marrëveshje, janë dhënë 23.373 fleta evidente, janë mbjellë 14.415 hektarë duhan, janë paraqitur 26.630 kilogram duhan, por janë blerë 23.500 kilogram me çmim mesatar prej 217.70 denarë për kilogram. Oda Ekonomike e Maqedonisë dje doli me vlerësim se për shkak të kushteve jo të volitshme të motit, të cilat e kanë ulur sasinë dhe cilësinë e duhanit, pritet çmim më i ulët blerës dhe vlerësim në klasa më të ulëta.

ELEZI NË TBILISI TË GJEORGJISË

Standarde ndërkombëtare për evazionin fiskal

Shkup, 17 korrik - Republika e Maqedonisë i përcjell standardet ndërkombëtare dhe trendet për parandalim të evazionit fiskal dhe shmangies së pagesës së tatimit, theksoi zëvendësministria e Financave, Shiret Elezi në konferencën e titulluar "Përmirësim i bashkëpunimit ndërkombëtar: Luftë kundër evazionit tatimor", e cila mbahet në Tbilisi, Gjeorgji. Zëvendësministria, siç kumtoi Ministria e Financave, theksoi se Maqedonia deri në fund të vitit 2019 do t'i implementojë standardet BEPS (Base Erosion and Profit Shifting). "Këto standarde i përkasin zvogëlimit të mundësive për

evitim të pagesës për evitim të pagesës së tatimit përmes përcjelljes së profitit në të ashtuquajturat parajsë tatimore. Maqedonia bashkëpunon edhe me Forumin global për transparencë dhe shkëmbim të informacioneve", tha Elezi. Ajo shtoi se si kornizë juridike dhe bazë për parandalim të evazionit fiskal, Republika e Maqedonisë i shfrytëzon edhe marrëveshjet për evitim të tatimit të dyfishtë, sikur të cilat Maqedonia ka lidhur me 48 vende. Në konferencën e nivelit të lartë, marrin pjesë edhe ministri i Financave i Gjeorgjisë, Ivane Makavarfiani, guvernatori i Bankës Qendrore të Gjeorgjisë,



Koba Gvenetaxhe, drejtori i Qendrës për politika tatimore pranë OECD Paskal San - Aman dhe zëvendës ministri i Ekonomisë dhe Financave të Shqipërisë, Elton Haxhi. Në forumin pjesë 20 vende me mbi 60 pjesëmarrës, përfaqësues të Ministrisë së Financave, bankave popullore, drejtorë të drejtorive për të ardhura publike, përfaqësues të Komisionit Evropian, të Bankës Botërore dhe OECD.

RIKOSTRUIM I TËRËSISHËM I DY ÇERDHEVE NË TETOVË

NË PRITJE TË ÇERDHEVE SË RE NË TETOVË

Arifi është shprehur se po punohet edhe në rregullimin e qendrave ditore që priten të hapen në dy fshatrat e Malësisë së Tetovës, ndërsa ka theksuar se projekti për një çerdhe të re që pritet të ndërtohet tek shkolla "Kirili dhe Metodi", tashmë është dorëzuar i kompletuar në Qeveri



tohet tek shkolla "Kirili dhe Metodi", është dorëzuar i kompletuar në Qeveri dhe presin që i njëjti të marrë përkrahjen e Qeverisë.

"Ne në njërin prej thirrjeve që bëri Qeveria, për sa i përket projekteve nga komuna e Tetovës, ne dorëzuar projekt të plotë me leje të plotfuqishme për lokacionin tek shkolla 'Kirili dhe Metodi' dhe atje faktikisht projekti që ne kemi dorëzuar, është një projekt mjaft i madh që ka po ashtu të gjitha kapacitetet po aq të mëdha sa ky pozicion. Shpresojmë që ajo do të gjejë përkrahjen e vet. Në të njëjtën kohë ajo, që ne vazhdojmë pas hapjes së çerdhes në vendbanimin Xhepçisht që të njëjtën të shohim të mbulojmë edhe pjesë të tjera suburbane të Komunës së Tetovës dhe jemi në përgatitje e sipër të dy qëndrimeve ditore në dy lokalitete të Malësisë së Tetovës, të cilat poashtu për këtë vjeshtë do të jenë të gatshme për të filluar", tha kryetarja e Komunës së Tetovës. Në pritje të ndërtimit të çerdhes së re në Tetovë aktualisht janë me qindra prindër që ndodhen në listat e pritjes për të dërguar fëmijët e tyre në çerdhe. Sipas informacioneve, çerdhja tek shkolla Ekonomike ka kapacitet për 120 fëmijë, ndërsa janë regjistruar 170. Në çerdhen "Teteks" kapaciteti është për 160 fëmijë, kurse janë pranuar 220. Çerdhja e Vjetër gjithsej ka kapacitet për 90 fëmijë, kurse janë regjistruar 130. Në objektin e lagjes Potok kapaciteti është për 120 fëmijë, kurse 165 janë të regjistruar.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 17 korrik - Pesë milionë denarë do të investohet për rikonstruimin e tërësishëm të çerdhes Rinia 1 dhe 2 në Tetovë. Drejtoresha e çerdhes "Rinia", Ramije Dauti, është shprehur se ky investim është i pari që nga ndërtimi i objekteve në vitet e 70-ta, dhe sipas saj, ky investim do të rrit edhe sigurinë e fëmijëve, por edhe do të kenë hapësira më shumë ku mund të argëtohen. "Do të jetë ky një renovim total i këtij objekti, respektivisht dy objekteve Teteks 1 dhe Teteks 2. Bazohemi në atë që do të ketë ndërrim të ndriçimit, kanalizimit, ujësjellësit... gjithashtu hapësirat që i kemi këtu të gjitha do të kenë një pamje tjetër. Renovime kemi pasur çdo vit nga pak, por këtë radhë vendosëm që të rregullojmë tërësisht objektin pasi kjo

RIDEFINOHEN KRITERET PËR DOTACIONE PËR KOMUNAT

Qeveria miratoi informatë për aktivitetet për ridefinim të mënyrës dhe konfirmim të kriterëve për dotacionet e dedikuara dhe bllok për komunat. Qeveria e ka angazhuar Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale që deri në fund të vitit të dorëzojë propozim për ridefinim të mënyrës dhe konfirmim të kriterëve për dotacionet e dedikuara dhe bllok për komunat,

informoi pres-shërbimi qeveritar. Me propozim të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Qeveria e ka shqyrtuar dhe pranuar propozim-dekretin për metodologjinë për konfirmim të kriterëve për shpërndarje të bllok dotacioneve për institucionet publike për fëmijë - kopshte nëpër komuna për vitin 2019, njoftoi pres-shërimi qeveritar.

nuk është bërë ashtu siç duhet nga koha kur janë ndërtuar Teteks 1 në vitin 1977, ndërsa Teteks 2 në 1973 dhe prej atëherë nuk kemi pasur kështu lloj renovimi", tha Ramije Dauti, drejtoresha e çerdhes Rinia në Tetovë. Ndërkohë në inspektimin e punimeve në çerdhe që bëri sot, kryetarja Teuta Arifi është shprehur se investimet nuk mun-

gojnë edhe nëpër institucionet tjera arsimore.

"Gjatë kësaj periudhe të verës, meqenëse kemi punë intensive edhe në shumë institucione tjera arsimore, i është dhënë një rëndësi e madhe pikërisht krijimit dhe rritjes së standardeve me qëllim që të mundemi të kemi vende sa më të mira për sa u përket fëmijë-

ve. Investimi që bëhet sot është investim prej pesë milionë denarësh dhe që përfshin investim prej mjeeteve vetanake", tha Arifi. Ajo më tej është shprehur se është duke u punuar edhe në rregullimin e qendrave ditore që priten të hapen në dy fshatrat e Malësisë së Tetovës, ndërsa ka theksuar se projekti për një çerdhe të re që pritet të ndër-

Në Shemshovë filloi turneu kushtuar Rahim Samiut

Tetovë, 17 korrik - Në fshatin Shemshovë të komunës së Jeganocit ka filluar turneu tradicional në futboll të vogël kushtuar dëshmorit të kombit Rahim Samiut, i njohur si komandant Zogut, i cili ishte pikërisht nga ky fshat. Përmes këtij organizimi rinia e fshatit Shemshovë përkujton veprën e komandant Zogut. Organizatorët kanë theksuar se turneu mbështete edhe nga shumë spoznor nga ky fshat dhe nga bashkëfshatarët. Përndryshe, në këtë turne në futboll të vogël, marrin pjesë mbi 20 ekipe nga rrethina e Tetovës dhe do të zgjasë disa ditë.

GOSTIVARI MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME WHE

Gostivar, 17 korrik - Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari dhe drejtori i kompanisë "Waterloo Hastings Energy", Philippe de Beauregard, nënshkruan dje një Memorandum bashkëpunimi për zbatimin e projekteve në nivel lokal dhe rajonal, me theks të veçantë trajtimin e mbetjeve dhe ujërave. Qëllimi i këtij memorandum është bashkëpunimi në fushën e zhvillimit ekonomik, krijimin e partneriteteve publike-private, si dhe kujdesi mjedisor dhe trajtimi i mbeturinave dhe ujërave.

Pas nënshkrimit të Memorandumit, kryetari i komunës së Gostivarit, Arben Taravari, në pres-konferencë shprehu kënaqësinë e veçantë për nënshkrimin e memorandumit me një kompani që do të bëjë investim në deponinë rajonale të Rusinos.

"Muajin e ardhshëm do t'i defi-



nojmë të gjitha detajet për kontratën për investimin që do të jetë partneritet publiko-privat, ku do të parashihet saktë periudha kohore e implementimit të projektit. Shpresoj se do të kemi edhe përkrahjen e qeverisë, sepse ne tashmë e kemi kryer obligimin që kërkohej nga ne, respektivisht të krijojmë partneritet publiko-privat dhe shpresoj se shumë shpejt do të nënshkruhet edhe kontrata për inve-

stim, respektivisht në fillim të muajit shtator, pas përcaktimit të të gjitha detajeve të nevojshme", deklaroi kryetari Taravari.

Ai nënvizoi se krahas menaxhimit të mbetjeve, do të bëhet edhe reciklimi i tyre si dhe do të prodhohet rrymë elektrike në të njëjtin vend, me çka do të zgjidhet problemi me mbeturinat për gjithë rajonin e Pollogut dhe do të kemi edhe dobi ekonomike nga ky

projekt. Nga ana tjetër, drejtori i kompanisë franceze "Waterloo Hastings Energy", Philippe de Beauregard, theksoi se kompania e tij është e gatshme për krijimin e partneritetit publiko-privat me Komunën e Gostivarit dhe se investimi në lidhje me këtë projekt gjigant në deponinë Rusino, do të bëhet 100 për qind nga ana e kompanisë së tij, thuhet në kumtesën e komunës së Gostivarit.

Pas takimit të fundit të G-7, disa kombe evropiane si Franca dhe Gjermania, u shprehën të zemëruara se pikëpamjet e tyre patën një përkrahje të pakët nga Donald Trump. Edhe në think-tanket e njohura mbi politikën e jashtme, një temë e vazhdueshme ka të bëjë me udhëheqësit evropianë, që ankohen se përse Evropa nuk po respektohet më në skenën botërore. Po pse vallë?

Në fund të fundit, nëse "Evropa" përcaktohet nga anëtarësia e 28 anëtarëve të Bashkimit Evropian, atëherë duhet të jetë lehtësisht superfuqia e botës. Projekti evropian, ka aktualisht një popullsi të përgjithshme (512 milionë), që lë në hije atë të Shteteve të Bashkuara (326 milionë). Madje edhe PBB-ja e saj (20 trilionë dollarë), është më e madhe se e Amerikës (19 trilionë dollarë). Historikisht, gjeografia evropiane ka qenë me një ndikim strategjik - me dalje në Atlantik, Baltikun dhe Mesdhe, lidhja e lashtë detare e tre kontinenteve. Roma është qendra e krishterimit, deri më tani feja më e madhe në botë. Disa nga kombet e mëdha në botë - Argjentina, Australia, Brazili, Kanadaja, Kili, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara, lindën si koloni evropiane.

Rreth 2 miliardë njerëz flasin gjuhë evropiane, duke përfshirë qindra milionë jashtë Europës, gjuha e parë e të cilave është anglishtja, spanjishtja, portugalishtja ose frëngjishtja. Prodhimet evropiane - Airbus, BP, Shell dhe Volkséagen - janë emra globalë. Franca pret çdo vit numrin më të madh të turistëve të botës. Evropa është në tërësi, më e vizituara se sa çdo komb tjetër ose zonë gjeografike - dhe kjo nuk është e habitshme, duke qenë se ajo ka qenë shtëpia e përparimeve më të rëndësishme të qytetërimit: lindja e qytet-shteteve, shfaqja e republikanizmit romak dhe perandorisë së saj më vonë të globalizuar, Rilindjes, Reformimit, Iluminizmit dhe Revolucionit Industrial.

Shumë nga mendimtarët, shkrimtarët, shkencëtarët dhe politikanët më të mëdhenj në botë ishin evropianë, nga Platoni, Sokrati Ciceroni, Oktaviani dhe Perikliu, deri tek Koperniku, Dante, Galileo, Da Vinçi, Njutoni, Shekspiri, Servantesi, Ajnshtajni dhe Çerçilli.

Po kështu, katastrofat më të mëdha në historinë botërore u zhvilluan në tokën evropiane: Vdekja e Zezë, gjenocidi i Stalinit në Rusi, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, dhe Holokausti. Edhe tradita ushtarake perëndimore, lindi në Europë, dhe po ashtu ushtritë më vdekjeprurëse të botës në histori - romake, franceze, gjermane - ishin të gjithë evropiane, siç ishin komandantët më të aftë, nga Aleksandri i Madh dhe Jul Çezari, deri tek Napoleoni dhe Uellingtoni. Pse atëherë liderët evropianë, po ndihen gjithnjë e më shumë të parëndësishëm, pa besim në të kaluarën e tyre, dhe shpesh të injoruar nga fuqitë e

Pse Evropa nuk respektohet më!

mëdha? Në pjesën më të madhe të diplomacisë së nivelit të lartë, Evropa është kryesisht spektatore. Revolucioni i teknologjisë së lartë që kreu Amazon, Apple, Google, Facebook dhe Microsoft, e shmangu Europën.

Gjykuar nga përcaktuesit e mëdhenj historikë të fuqisë civilizuese - karburanti, energjia, arsimit, demografia, stabiliteti politik dhe fuqia ushtarake - në Europë po pakësohet. Ajo po shpenzon vetëm 1.4 për qind të PBB-së së saj kolektive në mbrojtje. Shumica e analistëve, arrijnë në përfundimin se edhe ajo që Evropa shpenzon për sigurinë, nuk përkthehet drejtpërdrejt në gatishmëri ushtarake, të paktën në krahasim me ushtrinë amerikane. Dhe me një shkallë të lindshmërisë prej më pak se 1.6 për qind, Evropa po zvogëlohet demografikisht dhe po plakët - prandaj Angela Merkel e sheh me sa duket e sheh emigracionin edhe si një zgjidhje për krizën e demografisë, dhe një furnizim të krahut të punës me kosto të ulët. Ndërkohë Evropa mbetet e ndërvarur nga Rusia, Azia Qendrore dhe vendet e OPEC-ut për shumicën e nevojave të saj energjetike. Në renditjet botërore të 20 universiteteve më të mira, vetëm njëri ishte një kontinental evropian; ndërkohë, 15 ishin amerikanë dhe 4 britanikë. Politikisht, Bashkimi Evropian nuk ka ditur të akomodojë si duhet bashkimin e popujve, gjuhëve dhe kulturave të ndryshme

në një komb paneuropean. Rezultati është frustrimi dhe polarizimi, pasi BE po fragmenterizohet. Europiano-lindorë, ngrenë krye kundër presioneve nga Berlioni dhe Parisi, dhe po fillojnë të refuzojnë hyrjen e çdo lloj myslimani nga Lindja e Mesme. Ndërkohë, evropianët e Mesdheut e shohin barrën e tyre në përballimin e emigracionin masiv të paligjshëm, jo vetëm si të nënvlerësuar, por edhe si një shfaqje tjetër të një diktati financiar më të hershëm të Europës Veriore.

Ndërkohë, Mbretëria e Bashkuar është në prag të largimit. Në qendër të këtyre tensioneve rajonale qëndron Gjermania, vendi më i madh i BE-së, dhe me historinë më problematike. Në teori, Gjermania pohon se nuk është më dhunuesja e viteve 1871, 1914 dhe 1939. Në fakt, Berlioni tregon pak durim me ata që kundërshtojnë planet e tij për t'u marrë me Brexit, emigracionin mysliman. Sondazhet e fundit, tregojnë një rënie të përgjithshme të besimit tek Bashkimi Evropian nga anëtarët e tij. Në disa vende, BE-ja nuk fiton shumicën e mbështetjes. Një etikë kontinentale e agnosticizmit, varësisë së shtetit, mungesës së fëmijëve dhe multikulturalizmit, e lë Europën veçanërisht të prekshme ndaj sfidave të jashtme të një lagueje të rrezikshme, dhe flukseve masive të emigrantëve kryesisht myslimanë, teksa popullata e saj e zvogëluar, rrezikon të bëhet e paaftë për të mbështetur

Bashkimi Evropian ka mbetur me mitologjinë se vetëm pan-europianizmi e ka ruajtur së paku paqen për gati 75 vjet, periudha më e gjatë të qetësisë kontinentale të pandërprerë, që nga bashkimi i Gjermanisë më 1871. Një naivitet i tillë merr pak në konsideratë rolin e një NATO-je të drejtuar nga SHBA...



mirëqenien shtetërore, dhe pagesat e pensioneve të një popullsie të plakur.

Një zgjidhje amerikane për krizën evropiane - liberalizimi, ulja e taksave, më shumë referendume dhe plebishite, rritja e shpenzimeve të mbrojtjes, grumbullimi i gazit natyror dhe i naftës, siguria kufitare - do të ishte e pamendueshme. Një kthesë e tillë do të ishte e kundërt me perceptimin vetë-vlerësues dhe të pretendimeve humanitariste të elitës evropiane, dhe do të sjellë një pranim kolektiv të dështimit. Bashkimi Evropian ka mbetur me mitologjinë se vetëm pan-europianizmi e ka ruajtur së paku paqen për gati 75 vjet, periudha më e gjatë të qetësisë kontinentale të pandërprerë, që nga bashkimi i Gjermanisë më 1871. Një naivitet i tillë merr pak në konsideratë rolin e një NATO-je të drejtuar nga SHBA, dhe një Gjermania anormale, vendi më i madh dhe më dinamik i Evropës, si dhe kombi historikisht më agresiv, nuk zhvilloi armë bërthamore, ndërsa armiqët tradicionalë të vijës së parë në dy luftëra botërore, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar po. Duke konfirmuar se fuqia, dhe jo pretendimi për fuqi, e ruan paqen.

Zemërat evropiane mbi Donald Trump nuk është, siç pohohet, sepse ai dhe kombi që e zgjodhën atë janë të vrazhdë, por sepse ai dhe vendi i tij janë të nevojshëm më shumë se kurrë, për një kontinent që ka humbur rrugën e vet. (Hoover Institute)



Nga
Victor DAVIS HANSON

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaša lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 17 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Liderët nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi - u mbledhën në Londër, për samitin e fundit, të asaj që njihet si Procesi i Berlinit. Duke lënë mënjanë kontradiktën e dukshme të një vendi që po largohet nga BE-ja, duke organizuar një takim që synon të zgjerojë anëtarësimin e Unionit, koha nuk mund të ishte më e pafat për Britaninë, ose më mirë për Brukselin. Udhëheqësit e Ballkanit arritën po ashtu, kur shkrija e Brexit arriti në lartësitë e reja në Londër me dorëheqjen e David Davis, njeriu që udhëhoqi negociatat e Brexit për qeverinë britanike. Ironia e errët e një vendi që bie politikisht kur kërkon të dalë nga BE-ja, ndërsa i mirëpret drejtuesit e shteteve që synojnë të bëhen më të qëndrueshëm duke iu bashkuar Unionit. Por, përtej këtij argëtimi, nuk ka dyshim se shumë nga ata liderë ballkanikë të mbledhur në Londër, do të kenë dyshime nëse vendet e tyre do të hyjnë me të vërtetë në BE. Ndërsa zyrtarët e lartë nga institucionet europiane dhe vendet anëtare të BE-së janë të bindur se zgjerimi do të vazhdojë, shumë në Ballkan besojnë se Unioni nuk është aq i angazhuar për zgjerimin siç sugjerohet.

Në disa perceptime, frika e tyre është e kuptueshme. Edhe pse zgjerimi ka qenë një gur themeli i projektit europian që u rrit nga Komuniteti Ekonomik Europian me gjashtë anëtarë në fund të viteve 1950-të, në 28 sot, dëshira për zgje-

Britania në BREXIT, Ballkani në pritje

Rreziku është se Ballkani Perëndimor është gjithnjë e më i prekshëm ndaj ideve të populizmit dhe autoritarizmit zvarritës, si disa pjesë të tjera të Europës këto ditë. Ashtu si largimi nga BE-ja është duke shkaktuar trazirë në Britani, duke mohuar apo edhe thjesht duke shtyrë në mënyrë të panevojshme anëtarësimin në Bashkimin Europian mund të ushqehet paqëndrueshmëri në Ballkan



rim të mëtejshëm duket të ketë rënë. Kjo është, për dy arsye. Së pari, ndërsa shumë prej 13 vendeve të reja që janë bashkuar me BE-në që nga viti 2004, janë përshtatur mirë, të tjerët nuk janë përshtatur si duhet. Shumë besojnë se Bullgaria dhe Rumania, të cilat u bashkuar në 2007, nuk ishin gati dhe tregojnë shqetësime serioze lidhur me korrupsionin dhe sundimin e ligjit. Të tjerë tregojnë për shtyrjen politike



të Polonisë dhe Hungarisë, të cilat dikur ishin dhurata të BE-së. Për disa, ka vetëm një ndjenjë, se BE-ja është zgjeruar shumë shpejt. Ajo duhet të mësojë të jetojë si një trup i madh përpara se të rritet më. Së dyti, BE-ja është përballur me një periudhë trazirash të brendshme të paprecedentë. Përveç Brexit, kriza financiare dhe migrimi masiv, e kanë vënë unitetin europian në provën e fundit gjatë dekadës së fundit. Këto çështje duhet të zgjidhen përpara se të afrohen shtetet e reja anëtare. Po ashtu, ka argumente të forta në favor të zgjerimit. Në një nivel emocional dhe si një aspiratë politike, nuk ka dyshim se zgjerimi me Ballkanin Perëndimor,

mbetet një synim i sinqertë në Bruksel dhe kryeqytete të tjera europiane. Praktikisht, procesi i zgjerimit është ende në rrugën e duhur. Mali i Zi, i cili aktualisht udhëheq paketën, ka hapur 31 nga 35 kapitujt e legjislacionit të BE-së, që duhet të kodohen në ligjin vendas para se të mund të bashkohen.

Pas kësaj është Serbia, e cila tani ka hapur 14 kapituj. Një dokument i kohëve të fundit i strategjisë së BE-së sugjeroi që të dyja vendet mund të jenë në gjendje të bashkohen deri në vitin 2025. Sidoqoftë, dyshimet vazhdojnë. Për këtë, BE ka shkaktuar për të fajësuar. Në një takim të ministrave të jashtëm të BE-së muajin e kaluar, vendimi për të ha-

pur bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë, si dhe me Shqipërinë fqinjë, u shty nga kundërshtimet e Francës dhe Holandës. Rreziku është se Ballkani Perëndimor është gjithnjë e më i prekshëm ndaj ideve të populizmit dhe autoritarizmit zvarritës, si disa pjesë të tjera të Europës këto ditë. Ashtu si largimi nga BE-ja është duke shkaktuar trazirë në Britani, duke mohuar apo edhe thjesht duke shtyrë në mënyrë të panevojshme anëtarësimin në Bashkimin Europian mund të ushqehet paqëndrueshmëri në Ballkan.

(Autori është ekspert në Institutin Europian, Londër, Shkolla e Ekonomisë dhe Shkencave Politike)

Nga

James KER-LINDSAY



Ministria e Jashtme ruse e ripostoi një tweet të Trumpit duke i vënë atij kësaj vulën zyrtare të Kremlinit. Presidenti amerikan në postimin e tij akuzon SHBA-në e si rrjedhojë edhe vetveten, si përgjegjës për raportet e këqija me Rusinë, madje shkruan, kjo sepse SHBA ka vepruar "me budalallëk". A është SHBA vet fajtorë, që shërbimi sekret rus ka ndërhyrë me haker në autoritetet elektorale partiake dhe që presidenti rus ka pushtuar Krimenë? Kjo është thjesht qesharake, por edhe një veprim i paparë ndonjëherë në historinë e re amerikane. Me tezat e tij ai e ka diskualifikuar veten sërisht.

Kështu nuk është sjellë asnjëherë ndonjë president. E një president nuk duhet të veprojë kështu. Pyetja është, se edhe sa kohë republikanët dhe mbështetësit e presidentit do të duan të vazhdojnë ta përballojnë këtë president të paafte dhe të çoroditur në Shtëpinë e Bardhë? Trump belbëzon vazhdimisht fjali të përgjysmuara kundërthënëse. Disa prej tyre nga ditët e fundit: Herë NATO-ja i merr shpirtin SHBA-së, e herë tjetër ajo është si një festë e dashurisë. Herë BE-ja është armik, e

Samiti zhgënjyes

Presidenti i SHBA-së në takimin me burrin e fuqishëm të Rusisë tregon dobësi evidente. Ai është personi i gabuar në arenën ndërkombëtare



herë Kina është armike, ose të dyja bashkë. Herë Britania e Madhe duhet të padisë BE-në për Brexit, herë kryeministrja May është mikja më e mirë. Pastaj Gjermania është si rob në duart e Putinit, por njëkohësisht Putini është një konkurrent korrekt.

Belbëzimi i tregtarit të imobiljeve të shndërruar nga yll televizionit në kryepopulist është e vështirë të durohet. Krahasuar me presidentin rus, Trump duket i dobët, i pasigurt, i papërgatitur.



Gjithmonë kur Trump shkaktonte dëme në kampin e politikës së jashtme, ministrave të tij u duhet t'i rivendosin gjërat në vend dhe t'i përkthejnë sërish në politikë fjalët e marra të një presidenti që i lë pasdore faktet. Edhe sa kohë do të vazhdojnë ata ta ndjekin atë?

Putinit duket se i është vënë re një nënqeshje djallëzore gjatë paraqitjeve të tij me Trump në Helsinki. Atij i mjaftonte të rrinte i

qetë, të shihte e të dëgjonte se si Trump e shpërbën rendin global botëror. Javët e fundit ai e shpalli BE-në armik. Akuzat ndaj Putinit dhe Rusisë në SHBA mbeten në të kundërt pa asnjë efekt. A është përpjekur Putini, t'i influencojë zgjedhjet në SHBA më 2016, donte ai ta ngrinte Trumpin në post, a ka ai në dorë material dëshmie kundër klanit Trump? Nëse i mbledh të gjitha, mund të men-

dosh, se këtu diçka mund të ketë, që e detyron Trumpin të sillet kështu pikërisht përballë autokratit rus. Në Helsinki mund të thuash se më shumë ishte presidenti që takoi oficerin komandues. Egomani amator takon profesionistin e shkolluar të shërbimeve sekrete. E vetmja, që i bashkon të dy burrat, është se ata nuk e marrin aq seriozisht të vërtetën. Putin e ka bërë fare të qartë, që ai nuk synon të fitojë besimin, por do të realizojë interesat e veta. Natyrisht është mirë, që të dy burrat e pushtetshëm flasin me njeri-tjetrin. Por spektakli, që me sa duket dëshiron Trump nuk mjafton. Bota pret më shumë, këtë Trumpi e ka kuptuar në ato pak çaste të kthjellimit të tij. Pritshmëritë u zhgënjyen. E gjora Amerikë, që ka zgjedhur president këtë ekscentrik, të pakalkulueshëm dhe të rrezikshëm. Të shpresojmë që ai të mos shkaktojë edhe më shumë dëme. (DW)

Nga Bernd RIEGERT



Ata nuk e kuptojnë dhe kurrë nuk e kanë kuptuar se Guevara u bë hero për mënyrën se si ai jetoi dhe mbi të gjitha, si vdiq. Pak figura të tjera bashkëkohore publike e kanë arritur figurën e tij, veçanërisht në vendet socialiste. Nuk ka bluza me fytyrën e kreut sovjetik Leonid Brezhnev, shqiptarit Enver Hoxha ose kamboxhianit Pol Pot

Nga John Lee Anderson


Më 9 tetor 1967, kur ushtria boliviane dhe agjentët e CIA-s vendosën që të vrisnin Ernesto "Che" Guevara de la Serna në fshatin La Higuera, në rajonin e Santa Cruzit, ata ishin të bindur se vdekja e tij do të ishte dëshmi e dështimit të përpjekjeve komuniste në Amerikën Latine. Nuk ndodhi. Në kundërshtim me pritjet e tyre, vdekja e Guevarës u bë miti themelues për gjeneratat e mëvonshme të revolucionarëve, të cilët u frymëzuan nga guerilasi dhe u përpoqën ta imitojnë atë.

"Si mund të shkojnë pas një të dështuari?", është pyetja që gjithmonë do të bëjnë kundërshtarët e Guevarës, Fidel Castros, revolucionit kuban dhe të gjithë ata që kanë kërkuar të nxisin një revolucion socialist në Amerikën Latine, gjatë pesëdhjetë viteve të fundit. Luajnë mendsh kur shohin të rinj nga vendet e tjera, madje edhe më i fuqishmi i botës kapitaliste, Shtetet e Bashkuara, që veshin bluza me fytyrën e Che dhe, më keq akoma, tregojnë simpatinë e tyre për "luftëtarin heroik", siç kujtohet zyrtarisht në Kubë. Ata nuk e kuptojnë dhe kurrë nuk e kanë kuptuar se Guevara u bë hero për mënyrën se si ai jetoi dhe mbi të gjitha, si vdiq. Pak figura të tjera bashkëkohore publike e kanë arritur figurën e tij, veçanërisht në vendet socialiste. Nuk ka bluza me fytyrën e kreut sovjetik Leonid Brezhnev, shqiptarit Enver Hoxha ose kamboxhianit Pol Pot.

NJË BURIM FRYMËZIMI

Krijimi i mitit të Guevarës nuk është vetëm rezultat i një fushate reklamash, alla "Mad Men". Nëse do të ishte kështu, "të tjerët" do të konsolidonin disa nga heronjtë e tyre në imagjinatën popullore, sepse në fund ata do të fitonin betejën e madhe të Luftës së Ftohtë. Po ku janë bluzat e argentinave Jorge Videlas dhe Alfredo Astiz, apo diktatorit kilian Augusto Pinochet? Për një numër arsyesh, duke përfshirë të qenit koherentë me idealët e tyre dhe gati për të vdekur për ato ideale, të mira apo të këqija, Guevara shkoi përtej rrethit të pasuesve të tij dhe u bë guerrilasi i përsosur. Një metamorfozë që transformoi dështimin e pamohueshëm në Bolivi, në

ÇFARË MBETET SOT NGA MITI I CHE GUEVARËS



një burim frymëzimi.

Fakti që Guevara ishte i ri dhe i pashëm kur vdiq, ka ushqyer legjendën e tij. Dhe fakti që trupi i tij i pajetë ngjante me atë të Jezusit, ndihmoi në ndërtimin e mitit pas vdekjes. I detë e Guevarës, të shprehura në librin "Socializmi dhe Njeriu në Kubë", ndoshta janë më pak të njohura sot për ndjekësit e tij të rinj, sesa portreti i famshëm i Alberto Kordës. Fytyra e "Che" është në vetvete një markë tregtare dhe simbol global i një sfide ndaj status quos-ë, rebelim i pastër, sidomos i të rinjve mitur, kundër padrejtësive. Është fytyra e indinjatës kundër një bote të mbushur me barbarazi, ku – thonë fytyra dhe trashëgimia e guerilasit – duhet të merret pozicion dhe, nëse është e nevojshme, të luftohet deri në pasojat ekstreme. Ka pak fytyra të tjera që mund të shprehin një mesazh të tillë.

Pjesërisht, kjo është arsyeja pse miti i Guevarës është ende gjallë. Ai u konsolidua në epokën kur TV zëvendësoi radion si një media masive, dhe lindën kultura pop dhe konsumizmi, në të cilën "ti je ajo që mban veshur" dhe jo domosdoshmërisht atë që bën.

NJË PARADOKS

Dhe ja ku jemi, pesëdhjetë vjet më vonë, në një botë ku marka është gjithçka: në Mbretërinë e Bashkuar nëse mbani rroba Burberry, jeni pothuajse me siguri një konservator; në Shtetet e Bashkuara, nëse ngisni një makinë Subaru, jeni një votues i Partisë Demokratike, ndoshta vegetarian, ose të paktën të tërhequr nga ushqimi organik. T-shirt i Guevarës thotë se keni një qëndrim sfidues ndaj botës, që nuk nënkupton një angazhim konkret, por që merrni pozicion. Ka edhe më. Në këtë epokë, ku secili ka një smartphone dhe shpenzon orë të tëra në rrjetet sociale, Guevara paraqet një paradoks: është lidhja me një botë reale të kaluar, dëshmia e prekshme se dy breza më parë, mijëra burra dhe grave, sidomos të rinj, bënë gjëra reale për të shprehur mospajtimin e tyre. Ky brez mund të ketë dështuar, por sot sakrificat e tij ka diçka romantike. Në vitet e fundit, disa përfaqësues të gjeneratës së re, të quajtur gjenerata smartphone, kanë ngritur pyetje të reja rreth Guevarës. Ata janë tërhequr nga figura e tij, por janë të shqetësuar në lidhje me tre gjëra: duan të dinë nëse ishte homofob, nëse ishte racist, dhe nëse është e

Çfarë duhet të mendojmë për Guevarën sot, në një botë ku Shtetet e Bashkuara qeverisen keq, nga një miliardë racist dhe i paaftë si Donald Trump, Bashkimi Sovjetik nuk ekziston më, por ka Vladimir Putinin, i cili është kreu i një Rusie ultranacionaliste, autoritar dhe jashtëzakonisht i korruptuar? Kina nuk është më vendi i Mao Cedunit, dhe as i batalioneve të fshatarëve dhe punëtorëve, të cilat Guevara i admironte shumë. Është një vend që jeton një kapitalizëm të shfrenuar





vërtetë që ishte "vrasës".

Njëzet vjet më parë, pothuajse askush nuk më bënte pyetje të tilla, një provë kjo e faktit se politika e identitetit ka vënë nën kontroll debatin publik, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë. Ndryshimi i perspektivës ndaj figurës së Guevarës më intereson dhe më shqetëson, për

Guevara nuk ishte racist dhe me aq sa di unë, as homofob. Po sikur të ishte? A janë qëndrimet e tij ndaj seksualitetit apo përkatësisë etnike, elementët më të rëndësishëm për të vendosur, nëse do ta admirojmë apo do ta përçmojmë? Çfarë duhet të mendojmë për Malcolm X? Ta admirojmë për guximin kundër racizmit të bardhë, apo ta dënojmë për fjalët e urrejtjes kundër "djallit të bardhë"? Çfarë duhet të themi për kohën që i parapriu angazhimin të tij, kur ishte keqbërës dhe detyronte gratë të prostitucionit?

Shqetësimi më i madh i shprehur nga të rinjtë është ai "Guevarës vrasës". Kjo është një pyetje që më është bërë shumë herë dhe kështu që, unë kam shpjeguar se Che Guevara, pavarësisht se sa bukur dukej bereta

dhe mjekra e tij, ishte një guerilas. Nuk ishte një markë apo aktor që luante rolin e luftëtarit. Kam shpjeguar se në atë botë reale, luftëtarët si ai luftonin me të vërtetë dhe kishin armë. Ata vranë, dhe nganjëherë vdiqën, për idetë e tyre. Gjithashtu kam shpjeguar se, sipas mendimit tim, ekziston një dallim mes të qenit një "vrasës" dhe një guerilas. Pavarësisht asaj që unë mendoj, është e vërtetë se Che Guevara ka ndjekur penalisht dhe dënuar me vdekje njerëz, në Sierra Maestra në Havanë gjatë gjyqimeve kundër përkrahësve të Fulgencio Batistas, pas triumfit të revolucionit në vitin 1959.

Me aq sa unë di, njerëzit e dënuar me vdekje dhe të pushkatuar në Sierra ishin vrasës, përdhunues apo tradhtarë. Armiqtë e kapur dhe vranë në Havanë ishin anëtarë të skuadrave të vdekjes, të shërbimeve të inteligjencës të Batistas, ose ishin ushtarë të cilët kishin kryer akte mizore. E pranojnë të rinjtë apo jo, mosmarrëveshja konjitive që disa prej

tyre përjetojnë kundrejt një ikone të kulturës pop, tregon shumë për atë se, çdo brez imponon përkufizimet e veta për figurat historike. Çfarë duhet të mendojmë për Guevarën sot, në një botë ku Shtetet e Bashkuara qeverisen keq, nga një miliardë racist dhe i paaftë si Donald Trump, Bashkimi Sovjetik nuk ekziston më, por ka Vladimir Putinin, i cili është kreu i një Rusie ultra-nacionaliste, autoritar dhe jashtëzakonisht i korrupsuar? Kina nuk është më vendi i Mao Cedunit, dhe as i batalioneve të fshatarëve dhe punëtorëve, të cilat Guevara i admironte shumë. Është një vend që jeton një kapitalizëm të shfrenuar.

TË GJITHË KAPITALISTË

Shtetet e Bashkuara kanë fituar Luftën e Ftohtë, ose të paktën betejën ekonomike. Njëzet e gjashtë vjet pas rënies së komunizmit, vendet ku kishte luftëra guerilase të frymëzuara nga Guevara, janë pothuajse të gjithë kapitalistë. Në Amerikën Latine përjashtimet janë Venezuela dhe Kuba, të cilat ende demonstrojnë socializmin e tyre. Në Nikaragua ekziston sandinisti i vjetër Daniel Ortega, i cili revolucionar është shumë pak.

Në vend që të fshihen në malet e vendeve të tyre për të ndjekur një ideal revolucionar, sot gjeneratat e reja të latino-amerikanëve të varfër dhe të marginalizuar të Amerikës Latine, emigrojnë në veri, për të bërë punë të pista në SHBA. Të tjerë hyjnë në bandat kriminale. Krimi i organizuar dhe narkotikët janë rritur dhe tashmë dominojnë të gjithë territoret e hemisferës. Betejat bëhen për çështje parash dhe jo më për të ndjekur idealin e "një bote më të mirë". Në Bolivi, ku Guevara u vra, qeveris Evo Morales, i cili nuk është vetëm presidenti i parë i zgjedhur në pesëqind vjet, në një vend me shumicë indigjene, por edhe një admirues i zjarrtë i guerrillasve argjentinas. Dhe në përvjetorin e betejës së fundit të Guevarës, e cila për përkrahësit e tij është 8 tetori (jo dita e vdekjes së tij më 9 tetor), Morales filloi përgatitjet për festimet për të nderuar guerilasin. Ndoshta në këto pesëdhjetë vjet diçka ka ndryshuar vërtet në sajë të pranisë së Ernesto "Che" Guevarës në Amerikën Latine. (bota.al)

Djaloshi më i trashë në botë dobësohet mjaftueshëm për të shkuar në shkollë

"Është mirë ta shohësh atë se si luan dhe shkon në shkollë si fëmijët e tjerë. Ai ka qenë gjithmonë një nxënës i shkëlqyer, megjithatë, arsimin u detyrua ta ndërpresë për shkak të peshës së tepruar, e cila ia vështirësoonte lëvizjen", tha Rokayah

Vetëm dy vjet më parë, djaloshi nga Indonezia, Arya Perman, ishte jashtëzakonisht i trashë dhe i kishte 200 kilogramë. Mbipeshja e tij e tepërt e pengonte atë të lëvizte, të luante dhe ai nuk mund as të ulej pa ndihmën e dikujt. Pasi që lindi me 3.17 kg, Arya hante pesë herë në ditë dhe shpesh hante sa dy persona të rritur. Ai u trash me shpejtësi abnormale, ndërsa prindërit e tij Rokayah dhe Ade u përpoqën të bënin gjithçka për ta ndihmuar djalin e tyre. Ata madje e çuan atë tek mjeku në fshatin e tij, por ai nuk pa asgjë alarmante në gjithë situatën. Ushqyerja e djaloshtit e përfshinte një numër të madh të karbohidrateve dhe yndyrave, ndërsa prindërit filluan të shqetësoheshin për shkak se e kuptuan se mbipeshja e pengonte atë ta bënte një jetë normale. Nëna Rokayah në një rast u tha mediave se ajo ndihej e pafuqishme. "Ai është vazhdimisht i uritur dhe ha sasi të mëdha të ushqimit. Gjithashtu, ai vazhdimisht ankohet për frymëmarrje të vështirësuar, por e gjitha që e bën është se ha dhe fle. Nuk ka dhimbje më të madhe sesa ta shihni djalin tuaj se si vuan, ndërsa në anën tjetër asnjë nënë nuk mund ta ndalojë fëmijën e vet të hajë. Nuk kemi para të mjaftueshme për t'u konsultuar me mjekët, sepse e kemi shpenzuar shumicën e parave në ushqimin e tij", shtoi nëna e djalit. Pasi që historia e djalit u bë e njohur në mbarë botën, ekspertët vendosën ta ndihmonin. Tani dy vjet më vonë, Arya ka shëndet shumë më të mirë, sepse pesha e tij është reduktuar në 121 kilogramë. Tani ai mund të ecë normalisht, të vrapojë, të luajë futboll, badminton dhe të shkojë në shkollë. Dieta e tij tani përbëhet nga fruta dhe perime të freskëta, pak oriz dhe qumësht dietal. Ai gjithashtu iu nënshtrua operacionit për zvogëlimin e lukthit, gjë që e ndihmoi atë të humbte peshë, pasi që konsumon më pak ushqime. Ndryshimi i Aryas e ka gëzuar nënën Rokayah, e cila është shumë e lumtur që djali i saj është përsëri aktiv. "Me të vërtetë jam shumë e lumtur kur shoh se djali im tani është më i shëndetshëm. Nuk mund ta përshkruaj se si ndihem aktualisht. Është mirë ta shohësh atë se si luan dhe shkon në shkollë si fëmijët e tjerë. Ai ka qenë gjithmonë një nxënës i shkëlqyer, megjithatë, arsimin u detyrua ta ndërpresë për shkak të peshës së tepruar, e cila ia vështirësoonte lëvizjen", tha Rokayah.



SI LINDI GAZETARIA E VERDHË DHE NDIKIMI I SAJ NË OPINIONIN PUBLIK



Me qëllim që të rriste shitjen e gazetës së tij, "New York Journal", në 1896 botuesi Wiliam Randolph Hearst ia mori karikaturistit gazetës "New York World" përmes një beteje të ashpër. Joseph Pulitzer, iu desh të gjente një karikaturist tjetër. Ndërkohë termi 'yellow kid' u bë term i ditës që nënkuptonte gazetarinë e verdhë e cila i jepte dorë sensacionalizmit në përshkrimin e ngjarjeve shoqëruar me skica e karikatura

Albana Lifschin

Gazetaria e verdhë është një stil i informimit të ngjarjes për publikun ku sensacioni del mbi faktet. Ky term 'yellow journalism' lindi në fund të shek të XIX në Nju Jork, gjatë konkurrencës midis dy gazetave më të mëdha të kohës, "New York World" dhe "New York Journal", me botues Joseph Pulitzer dhe Wiliam Randolph Hearst. Fillimisht gazetaria e verdhë nuk kishte të bënte me informimin e ngjarjes dhe përfaqsohej nga karikatura nga jeta e Nju Jorkut në lagjet e varfëra, të botuara në "New York World", skicime të Richard Outcauld, karikaturist i gazetës. Personazhi më i njohur i karikaturistit u quajt 'yellow kid' për shkak të ngjyrës në botim, prej nga erdhi dhe termi 'yellow journalism'.

Me qëllim që të rriste shitjen e gazetës së tij, "New York Journal", në 1896 botuesi Wiliam Randolph Hearst ia mori karikaturistit gazetës "New York World" përmes një beteje të ashpër. Joseph Pulitzer, iu desh të gjente një karikaturist tjetër. Ndërkohë termi 'yellow kid' u bë term i ditës që nënkuptonte gazetarinë e verdhë e cila i jepte dorë sensacionalizmit në përshk-

rimin e ngjarjeve shoqëruar me skica e karikatura. Gazetaria e verdhë fitoi një ndikim të madh në zhvillimin e ngjarjeve. Rasti më i përmendur është ai i luftës midis Amerikës dhe Spanjës për çështjen e Kubës. Kuba ka qënë për një kohë të gjatë koloni e Spanjës. Në këtë koloni kishte filluar lëvizja revolucionare për shpëtim nga Spanja e fitimin e pavarësisë. Botuesit e dy gazetave më të mëdha të Nju Jorkut, Hearst dhe Pulitzer i kushtuan vëmendje të madhe pasqyrimin të ngjarjeve në Kubë, shtypjes që i bëhej popullsisë nga qeveria spanjole, ndjekjen e atyre që kërkonin pavarësi deri tek internimi në kampe përqëndrimi. Disa herë nga gazetat u publikuan edhe ngjarje falso. Ngjarjet e ilustruara dhe me tituj të dukshëm që tërhiqnin lexuesit, rritën e tirazhin e gazetave. Në shkurt të vitit 1898 marëdhëniet midis SHBA dhe Spanjës erdhën drejt përkeqësimit me shpejtësi. Një letër private e ambasadorit spanjol Dupuy de Lome ku fliste keq për presidentin amerikan McKinley, ra në duart e Hearst-it dhe u be publike në gazetën e tij. Qeveria spanjole tërhoqi menjëherë ambasadorin e saj dhe kërkoi ndjesë. Piku i konkurrencës së dy gazeta-

ve me të mëdha arriti në 15 shkurt 1898 kur një anije lufte amerikane (Maine) u mbyt në portin e Havanës. Anija qe shpënë atje si demonstrim i forcës amerikane dhe në kohën kur një anije spanjole kishte mbërritur në NYC. Në 15 shkurt anija Maine u shkatërua nga shpërthimi i një eksplozioni në bord ku humbën jetën 260 detarë. Si Hearst ashtu dhe Pulitzer në gazetat e tyre deklaruan që shpërthimi në anije qe rezultat i një komploti spanjol. Megjithëse kjo nuk u provua, ky moment u kap dhe u zhvillua nga gazetaria e verdhë duke nxitur opinionin amerikan për luftë. Gazetat ndihmuan në krijimin e një klime të favorshme për shpërthimin e një konflikti ndërkombëtar dhe ekspansionit të influencës amerikane përtej kufijve të saj. Shumë qytetarë amerikanë kërkuan të deklarohej Lufta. Parulla e ditës qe: Mos harroni Maine!

Në 11 prill presidenti McKinley i kërkoi kongresit lejen për përdorimin e forcës në Kubë. Në fillim të Majit të atij vitit, filloi lufta amerikano-spanjole. Amerika ndërkohë deklaroi që ishte në favor të independencës së Kubës dhe jo aneksimit të saj.

KRONIKA KULTURORE E POLLOGUT

Manifestime kulturore në Bogovinë



Tetovë, 17 korrik-Komuna e Bogovinës këtë vit me rastin e ardhjes së mërgimtarëve ka paraparë një sërë aktivitete të cilët do të mbahen me moton Komuna e Bogovinës Feston. Aktivitetet sportive kanë filluar, ndërsa prej nesër vazhdojnë edhe aktivitetet kulturore. "Prej nesër vazhdojmë me aktivitete kulturore, ku me ... do të kemi piknik me artistët mysafir të kolonisë artistike të galerisë së arteve të Tetovës, me çka do të ketë ekspozitë të pikturave këtu në parkun e Bogovinës. Më 21-22 korrik do të organizohet Marshi 2018, ku do të ketë ecje malore deri te Liqeni i Bogovinës dhe kamping te Dukati i Novosellës. Me 21 korrik në ora 20:00, për të gjithë banorët e Komunës së Bogovinës organizojmë koncert të muzikës moderne në oborrin e shkollës fillore "Abdyl Frashëri"-Bogovinë, ku me performancat e tyre do të paraqiten: XXL BAND dhe Elita Ziberi, DJ Erol dhe Samba, Snoë Black, ndërkaq si mysafir special do të kemi aktorin e mirënjohur Burhan Amiri, i cili do të paraqitet me StandUp komedi. Me 24 korrik, në ora 21:00, në hollin e shkollës fillore "Abdyl Frashëri"-Bogovinë do të prezantohen filma të shkurtë të autorëve, të cilët edhe janë nga kjo komunë, pra dy filma të producentit dhe regjisorit z. Senad Abdul, si dhe të regjisorit Agim Abdulla. Pra, do të kemi filma nga Arnel Production dhe Galaktika Production, me çka pas përfundimit të filmave do të kemi mundësi të bashkëbisedojmë me të dy regjisorët. Projektin "Komuna e Bogovinës Feston" do e përmbylim me koncertin e muzikës popullore me 1 gusht në ora 20:00, i cili do të organizohet në vendbanimin Pallçisht, ku me performancat e tyre do të paraqiten artistë të mëdhenj të muzikës popullore si Jetmir Rexhepi, Besarta Murtezani, si dhe SHKA Drita nga fshati Odër", tha Elmira Sejfullai, organizator i evenimenteve.

Përkujtohen disa figura kombëtare

Tetovë, 17 korrik-Organizata Joqeveritare Nisma 68, më 21 korrik, ditën e shtunë do të vazhdojë me aktivitetet për shënimin e 550 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe 50 vjetorit të Demonstratave të Tetovës. Sipas drejtuesve të Organizatës Joqeveritare Nisma 68, tashmë janë bërë përgatitjet që këtë të shtunë të mbahen dy aktivitete në dy fshatra të Malësisë së Tetovës. Bëhet fjalë për aktivitetin që fillon në ora 10 në fshatin Bozovcë, ku do të bëhet përrurimi i pllakës përkujtimore të rektorit të Parë të Universitetit të Tetovës prof.dr. Fadil Sulejmanit i cili lindi në këtë fshat. Pas këtij aktiviteti, më pas në fshatin Veshallë, në ora 11.30 minuta, do të vendoset pllaka përkujtimore, simbol i rrugës Historike Tetovë-Prizren me mbishkrimin "Sharri nuk ndan, Sharri Bashkon Dukagjin e Pollog". Më pas do të mbahet edhe një manifestim kulturor, sportiv dhe sofratradicionale shqiptare. Aktiviteti kryesor pritet të mbahet më 28 në Tetovë për çka organizatorët do të japin deataje në të ardhmen.

Në mendësinë publike që ishte imponuar me dekada kishte mbizotëruar teza se shqiptarët janë vetëm myslimanë dhe këtë tezë propaganda sllave e kishte përdorur për qëllime të veta, që në instancë të fundit kishte krijimin e arealeve civilizuese në kundërshtim me gjendjen faktike në terren. Dhe ishin pikërisht familjet katolike shqiptare në Shkup që e prishnin falcitetin e këtij diskursi civilizues, kurse libri që kemi në dorë është pasqyra më besnike e një kronologjie jo vetëm faktografike por edhe identitare që lidhej ngusht me shenjat dalluese të një etnie

BOTIME TË REJA

SHKUPI I DIKURSHËM, VJENA KULTURORE E SHQIPTARËVE



Koha

Emin AZEMI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, i udhëhequr nga dr. Skender Asani, po bëhet një zë i fuqishëm i afirmimit të vlerave dhe valorizimit të kritereve historike-shkencore për të kaluarën e lavdishme të këtyre trevave, që për shumë arsye kishin qenë të mbuluar me pluhurin e harresës. Tash së fundmi nga ky Institut doli edhe një vepër kapitale që trajton një nga temat më interesante që lidhet me komunitetin katolik shqiptar në Shkup. Autorët Skender Asani, Albert Ramaj dhe Natasha Didenko për herë të parë, në mënyrë të sistemuar dhe argumentuar, i ofrojnë lexuesit një panoramë shëtitëse nëpër kohë, duke na njohur nga afër me një sagë të gjerë familjesh bujare katolike në Shkup që kishin qenë vertikala shpirtërore e shqiptarëve në fund të shekullit 19 dhe fillim të shek. 20.

"Familjet katolike shqiptare në Shkup" është një vepër me shumë rëndësi për vetë historiografinë shqiptare, sepse autorët përmes dokumenteve, fotografive, faksimileve dhe dëshmimeve të ndryshme fokusojnë vëmendjen e lexuesit në disa shtylla që e bëjnë kujtesën tonë historike të liruar nga mjegullimet e panevojshme, që në rrethana e kontekste të caktuara na u imponuan.

Për të dëshmuar autoktoninë e pandërprerë të shqiptarëve në qytetin e Shkupit dhe për të argumentuar këtë tezë, autorët ka qenë dashur që të hulumtojnë traditën, folklorin, gjuhën, fenë dhe në përgjithësi trashëgiminë kulturore

të familjeve të vjetra katolike shqiptare. Ky objektivi që është gjithëpërfshirës në tërësinë e materialit hulumtues, zgjerohet me detaje përshkruese që si zanafillë kanë përpjekjet titanike të fisnikëve katolikë të Shkupit, personifikuar përmes familjeve Bojaxhiu, Serreqi, Ukajdari, Gjini, Ndreca, Marku e shumë të tjera, në funksion të ruajtjes së kontinuitetit të pandërprerë të traditës dhe mbamendjes kolektive shqiptare që nga antikiteti e deri në dekadat e mëvonshme të bashkëkohësisë sonë.

E vendosur mbi një bazament mjaft të fuqishëm argumentues, vepra në fjalë nuk kufizohet vetëm në observimet e tre autorëve, por shkon përtej duke marrë në shqyrtim edhe burime dhe autorë të vjetër antikë, me Shkupin si një nga qendrat parahistorike të civilizimit ilir dhe për rrjedhojë autoktonia e shqiptarëve në këtë qytet del si një hallkë materiale-shpirtërore e prezencës dhe vijimësisë iliro-dardane. Ky është edhe dimensionin më domethënës që e bën Shkupin të zë vend të merituar në kronikat dhe udhëpërshkrimet e shtegtarëve të ndryshëm që e kishin trajtuar këtë qytet si një nyje tregtare dhe rrugore që i lidhte akset strategjike më të njohura të Ballkanit, sikundër ishin: Via Dezeta (Shkup-Prizren-Shkodër); Via Egnatia (Shkup-Ohër-Durrës, dhe nga ana tjetër Selanik-Konstantinopojë); Via Naisus (Nish – Singidinum(Beograd) dhe Via Sertika (Sofje – Adrianopolis (Edrene).

Arkitektura e librit "Familjet katolike shqiptare në Shkup" është e ngritur mbi punën hulumtuese të tre autorëve që si udhërrëfim kanë pasur materialet arkivore të familjeve katolike në Shkup, por edhe fonde të shumta të dokumenteve e fotografive të marra nga arkivat e ndryshëm evropian (Arkivi Shtetëror i Vjenës, Arkivi Shtetëror i Luzernës, Arkivi i Qytetit në Budapest, Arkivi i Piedestar në Budapest, Arkivi i Famullisë së Prizrenit, Arkivi Propaganda Fide në Romë dhe Arkivi i familjes Kukaj në Vjenë).

Homogjeniteti shpirtëror i shqiptarëve me shekuj ishte ruajtur përmes kultivimit të traditës autoktone dhe ruajtjes së mvetësive etno-psikologjike. Ky homogjenitet nuk do të kishte kuptim pa Ipe-shkvinë Shkup-Prizren, bashkë me ipeshkvët dhe famulltarët që shërbyen në Shkup, duke filluar nga Pjetër Bogdani, e deri te Toma Rapsani, Dom Zef Ramaj, Lazër Mjeda etj. Të gjithë këta prijës, sipas burimeve që ofron ky libër, ndonëse mbanin veladonin e katolicizmit, me veprime konkrete ishin të lidhur me halllet e banorëve, duke iu ndihmuar atyre në emancipimin kulturor e kombëtar. Të ballafaquar me sfidat që impononte logjika e pushtimit otoman, këta ipeshkvë ishin edhe kronistë pe-

propaganda sllave e kishte përdorur për qëllime të veta, që në instancë të fundit kishte krijimin e arealeve civilizuese në kundërshtim me gjendjen faktike në terren. Dhe ishin pikërisht familjet katolike shqiptare në Shkup që e prishnin falcitetin e këtij diskursi civilizues, kurse libri që kemi në dorë është pasqyra më besnike e një kronologjie jo vetëm faktografike por edhe identitare që lidhej ngusht me shenjat dalluese të një etnie. Cjuha, arsimit, kënga, kostumet, mënyra e jetesës, ishte alfabeti shpirtëror i shqiptarëve, kurse katolikët shqiptarë të Shkupit i dhanë kuptim qenësisë kombëtare duke e integruar këtë alfabet në sfondin e përgjithshëm të civilizimit perëndimor, atje ku shqiptarët bënë pjesë. Libri i Asanit, Ramajt dhe Didenkos vë në pah pikërisht këtë poentë, ashtu siç del e pakontestueshme lidhshmëria e familjeve katolike shqiptare të Shkupit me përpjekjet për zhvillimin e arsimit shqip në Shkup dhe me rizgjim kulturor e shpirtëror të shqiptarëve. Kjo kauzë emancipuese-kulturore e këtyre familjeve shquhet përmes një galerie personazhesh mjaft të spikatur që kishin vepruar në Shkup, sikundër ishin Kolë Bojaxhiu, Dom Ndue Bytyçi, Lorenç Antoni, Dom Gaspër Gjini, Vingjenc Gjini e ndonjë tjetër. Sikur kjo traditë të kishte vazhduar edhe në ditët e sotme, sigurisht që Shkupi do të ishte Vjena kulturore e shqiptarëve.

Prandaj edhe ky libër duhet të shërbejë si nxitje për brezin e shqiptarëve të sotëm dhe të nesërm, që famën e Shkupit të dikurshëm ta rikthejë me projekte emancipuese e kulturore, kurse traditën e katolicizmit shqiptar në këtë qytet ta vendosë në parametrat konkurrues më botën e qytetëruar, atje ku gjithë shqiptarët synojnë të jenë.

dant të zhvillimeve në Shkup dhe më gjerë dhe kjo mund të dëshmohet në letrat dhe raportet që ata iu dërgonin jo vetëm Vatikanit, por edhe qendrave të ndryshme diplomatike dhe redaksive të gazetave evropiane. Kështu, bie fjala, Dom Zef Ramaj nga Stublla, një famullitar që gjithë veprimtarinë e kishte të lidhur me Famullinë e Shkupit, që njihet edhe si pagëzues i Gonxhe Bojaxhiut në Kishën Katolike në Shkup, më 27 gusht 1910, përpos fushëveprimit të tij fetar, ishte edhe mësues në shkollën shqipe pranë Famullisë së Shkupit, por edhe në Shkollën e Hekurudhës, shkollë elitare për kohën ku mësonin dhe fëmijët e diplomatëve të huaj. Jemi në kohën kur në Ballkan priteshin të ndodhin ndryshime dramatike gjeopolitike, kurse barra për të përballuar pasojat e këtyre ndryshimeve iu binte pikërisht këtyre përfaqësuesve shqiptarë të Kishës Katolike në Shkup. I tillë ishte edhe rasti me Dom Zef Ramajn i cili qe dëshmitar i masakrave serbe mbi popullatën shqiptare në Luftërat Ballkanike më 1912 dhe 1913, kur vakuumi i ikjes së turqve ishte mbushur me kronika rrëqethëse që si lajtmotiv kishin reprezaljet e soldateskës serbe e cila nuk kursente asgjë shqiptare dhe ishte pikërisht Dom Zef Ramaj që ato kronika ua dërgonte në formë letrash kancelarive të ndryshme evropiane dhe gazetave perendimore.

Sipas BE-së nuk ka mur në urën e Ibrit

Ndërtimet e fundit që po ndodhin afër urës së lumit Ibër në Mitrovicë janë në pajtim me marrëveshjet e arritura mes Kosovës dhe Serbisë dhe nuk është duke u ndërtuar asnjë mur i ri ndarës, ka njoftuar për Radion Evropë e Lirë, Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë. Ditëve të fundit mediat në Kosovë kanë raportuar se tashmë ka filluar ndër-

timi i një muri të ri afër urës së lumit Ibër që ka për qëllim ndarjen mes shqiptarëve dhe serbëve. "Plani i ndërtimit të rrethrotullimit në pjesën veriore të Mitrovicës është si rezultat i marrëveshjes së nënshkruar në Prishtinë me 4 Shkurt 2017 dhe në pajtim me marrëveshjen e Brukselit e nënshkruar me 25 gusht 2015. Kjo do të lidhë projektin e BE-së për revitalizimin e urës në

Mitrovicë dhe objekteve përreth, si dhe projektin për ta bërë rrugën "Mbreti Petar" ta kalueshme për këmbësorë", ka thënë ndër të tjerë kjo Zyrë. "Të gjitha punët pritet të përfundojnë në fund të këtij muaji", është thënë në deklaratë. Në fund të vitit 2016 komuna e Mitrovicës Veriore ka ndërtuar një mur të gjatë dy metra, çka ngjalli shumë reagime në Prishtinë. Muri



është rrenuar në shkurt të vitit 2017 pas një marrëveshje të arritur në

Prishtinë mes përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre serbë./REL

HAHN: VIJONI ME VETTINGUN



"BE dhe shtete të tjera pjesëmarrëse kanë mbështetur politikën e zgjerimit, ose do eksportojmë si union stabilitet ose do importojmë instabilitet. Kur bëhet fjala për Ballkanin Perëndimor, ky ribashkim do përfundojë kur vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë do anëtarësohen në BE.", tha Hahn

Komisioneri i zgjerimit në BE, Johannes Hahn, po zhvillon një mbledhje me qeverinë shqiptare të drejtuar nga kryeministri Edi Rama. Shefi i qeverisë shqiptare, në prani të zyrtarit të lartë të BE-së, ka theksuar se procesi deri në marrjen e rekomandimit të çeljes së negociatave nuk do të jetë i lehtë.

"Faza përgatitore do të jetë një angazhim i përditshëm. U përcaktua një afat i qartë për negociatat. E rëndësishme është që procesi të vijojë. Puna përgatitore nuk do të jetë e lehtë, megjithatë qeveria shqiptare do ta përdorë

kohën me efikasitet. Zotohemi se punën përgatitore do ta bëjmë me efikasitet të lartë, në mënyrë që të përmbushim konkluzionet dhe këshillat e BE-së", – shtoi Rama. Ndërsa, komisioneri Johannes Hahn, tha se ndodhet në Tiranë për të vijuar bisedimet për nisjen e punës përgatitore, duke filluar me një proces analitik.

Hahn nënvizoi se nevojitet një personel i mjaftueshëm dhe me përvojë në çdo ministri të linjës për të njohur sa më mirë legjislacionin e BE-së.

"BE dhe shtete të tjera pjesëmarrëse kanë mbështetur poli-

tikën e zgjerimit, ose do eksportojmë si union stabilitet ose do importojmë instabilitet. Kur bëhet fjala për Ballkanin Perëndimor, ky ribashkim do përfundojë kur vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë do anëtarësohen në BE. Zgjerimi ynë do përbëjë investim strategjik për paqe e stabilitetin në Europë. Në këtë këndvështrim jemi gati partnerë biznesi, – tha Hahn. – Është e rëndësishme ta nisim këtë proces për të mos humbur kohë dhe ditë për çdo përpjekje. Ky është një proces parësor e i detajuar që t'i japë administratës

shqiptare mundësi të familjarizohet me idetë dhe legjislacionin e BE-së". Hahn shpjegoi se Shqipëria dhe BE-ja po hyjnë në një fazë të re. "Në muajt në vijim, do zhvillojmë takime në Bruksel, kapitull pas kapitulli. Do të jetë thelbësore që të caktohen burime të mjaftueshme në personel e buxhetore, që të përballemi me një proces në çdo ministri të linjës, sepse duhet një personel i mjaftueshëm e me përvojë. Nga ana tjetër, duhet të vijojë reforma në sistemin e Vettingut dhe krijimi i institucioneve të reja ligjore".

Gazeta-Shqip.com

Tërmet në Shqipërinë e Mesme

Pak ditë më parë, paniku mbërtheu banorët në qytetet e Shqipërisë së Mesme, pasi një tërmet me magnitudë 5 ballë goditi vendin, me epiqendër pranë Gjirit të Lalzit. Tërmeti i parë u shoqërua nga qindra lëkundje më të lehta. Ndërkohë, ditën e martë vetëm pak pas orës 15:00, Shqipëria e Mesme u trondit sërisht, nga një tjetër tërmet, këtë herë me magnitudë 4.7 ballë dhe me epiqendër jo me pranë Gjirit të Lalzit, por në Rogozhinë.

Por ç'po ndodh me nëntokën e Shqipërisë, në vetëm kaq pak ditë me qindra tërmete dhe dy prej tyre të fuqishëm, por fatmirësisht pa persona të lënduar?! Sizmologët thonë se nuk ka vend për panik, sepse kjo është situatë normale, pasi çdo tërmet pasohet me lëkundje të tjera të vogla sizmike. "Është një situatë normale. Është një aktivitet normal në atë zonë, ka ndodhur edhe më parë", tha pak ditë më parë eksperti Ardian Minarolli, duke ulur panikun te qytetarët.

Vuçiqi bisedon me Macron për çështjen e Kosovës

Në Paris të martën është zhvilluar takimi mes presidentit të Serbisë, Aleksander Vuçiq, dhe atij të Francës, Emanuel Macron. Në një adresim për media pas takimit që zgjati një orë më shumë se sa ishte planifikuar, Vuçiq bëri të ditur se temë diskutimi e këtij takimi ishte edhe Kosova.

Ai tha se mori mbështetje nga presidenti francez për arritjen e një marrëveshje me Prishtinën, marrëveshje kjo që do të ishte në të mirë të rajonit. "Ne morëm mbështetjen për arritjen e një marrëveshjeje me

shqiptarët në Kosovë, në të mirë të sigurimit të paqes për të gjithë rajonin", u shpreh Vuçiq. Vuçiq shtoi se në këtë takim u fol edhe për dialogun e Brukselit mes Prishtinës dhe Beogradit, si dhe për marrëdhëniet bilaterale Beograd-Paris. Nga ana tjetër, presidenti Macron bëri të ditur se do të qëndrojë për një vizitë zyrtare në Serbi në nëntor të këtij viti. Ai kujtoi edhe historinë e të dy vendeve ku përmendi aleancat e mëparshme ushtarake mes Serbisë e Francës. "Ne kemi harruar se dikur kemi qenë

bashkë, ne e liruam Serbinë së bashku, nëse ju më jepni disa dokumente sot, atëherë kjo do të sillte obligime të reja mes nesh, sot ne jemi përsëri bashkë, në misionet për bashkëta në Mali e Liban", u shpreh Macron. Vuçiq në këtë takim e uroi Macronin për fitoren e Francës në Kampionatin Botëror të Futbollit, e presidenti francez i'a ktheu urimin, duke e përgëzuar atë për fitoren e Djokovic në turneun e tenisit në Wimbledon.

Në këtë konferencë për media, Vuçiq foli edhe për zbardhjen e vra-



sjes së liderit të SDP-së në Mitrovicën e Veriut, Oliver Ivanović, për të cilën tha se Serbia ka kërkuar regjistrime nga satelitët ndërkombëtare, por që të njëjtat nuk i janë dhënë.

Ai tha se ka përparime në hetim

met për vrasjen e tij, megjithëse tha se ende nuk ka ndonjë të dyshuar. Vlen të theksohet se takimi i sotëm Macron-Vuçiq zgjati më shumë se një orë, ndërkaq që ishte parashikuar të zgjaste vetëm 25 minuta. //lajmi.net/

DHE FITUES ËSHTË... PUTINI!



Ligji ndan izraelitët nga arabët, pritet kaos

Mike Carpenter, këshilltar për politikë të jashtme i ish-nënpresidentit amerikan, Joe Biden, tha se beson se Trump e ka ditur çfarë po bën kur ia ka dhënë Putinin platformën e tillë. "Humbës janë interesat e sigurisë kombëtare të SHBA-së dhe fitues është Putini dhe regjimi i Kremlinit që ai përfaqëson"



Në samitin në Helsinki, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe ai i Rusisë, Vladimir Putin, u zotuan se kanë ndërmarrë "hapat e parë" për përmirësimin e marrëdhënieve midis vendeve të tyre. Në konferencën për gazetarë, Trump hodhi dyshime mbi konstatimet e agjencive të tij të inteligjencës për ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet në SHBA, më 2016, dhe u duk se pranoi këmbënguljen e Putinin se duart e Rusisë janë të pastra. "Kam shumë besim te njerëzit e mi të inteligjencës, por dua t'ju them se presidenti Putin ishte jashtëzakonisht i fuqishëm në mohimin e tij sot. Nuk shoh ndonjë arsye që Rusia të ketë ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2016", tha Trump.

Ligjvënësit amerikanë, përfshirë republikanë dhe demokratë, e kritikuan fuqishëm Trumpin për këto deklarata, duke thënë se paraqitja e tij në konferencën për media ka qenë "bizare", "e turpshme" dhe "tradhti tronditëse ndaj detyrave të

tij". Richard Burr, kryetari republikan i Komitetit të Senatit për Inteligjencë, tha se Trump duhet ta pranojë si "gënjeshtër" çdo deklaratë të Putinin, që mohon se Rusia ka ndërhyrë në zgjedhje. Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, republikani Paul Ryan, tha se "nuk ka dyshim se Rusia" ka ndërhyrë në zgjedhje dhe se Trump "duhet të vlerësojë se Rusia nuk është aleat i Amerikës". "Nuk ka ekuivalencë morale midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, e cila mbetet armiqësore ndaj vlerave dhe idealeve tona", tha Ryan. Agjencitë amerikane të inteligjencës kanë konstatuar se Rusia ka ndërhyrë në zgjedhjet në SHBA, në favor të zgjedhjes së Trumpit president. Këshilltari i posaçëm amerikan, Robert Mueller, është duke hetuar bashkëpunimin e mundshëm të fshehtë midis fushatës së Trumpit dhe zyrtarëve rusë. Departamenti amerikan i Drejtësisë njoftoi më 13 korrik se një juri e madhe ka akuzuar 12 zyrtarë të

inteligjencës ruse për piraterimin e kompjuterëve të Partisë Demokratike në SHBA dhe publikimin e emailëve të vjedhura dhe të informacioneve të tjera, gjatë fushatës presidenciale në Shtetet e Bashkuara. Senatori republikan, John McCain, kryetar i Komitetit të Senatit për Shërbime të Armatosura, tha se paraqitja e Trumpit në konferencën për media në Helsinki "ka qenë një nga paraqitjet më të turpshme të një presidenti amerikan" dhe një "gabim tragjik". "Presidenti Trump tregoi jo vetëm se është i paafte, por edhe jogatishmëri për t'u ngritur kundër Putinin. Asnjë president i mëparshëm amerikan nuk e ka përlulur veten më keq para një tirani", tha McCain. Senatori tjetër republikan, Lindsey Graham, tha se samiti ishte një "mundësi e humbur" për ta mbajtur Rusinë përgjegjëse për ndërhyrje në zgjedhje.

"Ajo konferencë shtypi ishte një turp", tha Eliot Engel, përfaqësues demokrat në Komitetin e Kongresit

për Punë të Jashtme. "Presidenti bëri tradhti tronditëse ndaj detyrave të tij: mohoi sulmin e Rusisë mbi demokracinë amerikane, duke qëndruar në tokë të huaj pranë kundërshtarit kryesor të Amerikës", tha Engel. Takimi i Trumpit me Putinin mund të ishte edhe më i keq, tha për Radion Evropa e Lirë Keir Giles, analist nga Chatham House, institut në Londër. "Shumë njerëz po përqendrohen në përpjekjet e Trumpit për të diskredituar vendin e tij gjatë përbaljes me Vladimir Putinin, por, së paku, ai nuk kishte kohë për të hedhur aleatët e tij nën autobus", tha Giles. Për Will Pomeranz, zëvendës drejtor i Institutit Kennan për Studime të Avancuara Ruse, me seli në Uashington, fitues i samitit është Putini. "Të gjithë prisnin që Putin të dilte fitues dhe mendoj se ia doli. Putin dëshiron të perceptohet si një lojtar i madh global dhe Donald Trump ia dha konfirmimin e nevojshëm dhe platformën për atë status", tha Pomeranz. Mike Carpenter, këshilltar për politikë të jashtme i ish-nënpresidentit amerikan, Joe Biden, tha se beson se Trump e ka ditur çfarë po bën kur ia ka dhënë Putinin platformën e tillë. "Humbës janë interesat e sigurisë kombëtare të SHBA-së dhe fitues është Putini dhe regjimi i Kremlinit që ai përfaqëson", tha Carpenter.

Izraeli është në prag të një tronditje të fortë politike, ndërsa partia qeverisëse kërkon që të miratohet legjislacioni që do të lejonte krijimin e komuniteteve vetëm izraelite, diçka që kritikët e cilësojnë si fundi i shtetit demokratik.

Gjatë 5 viteve të fundit, politikanët kanë debatuar ashpër për detajet e ligjit që ka status të ngjashëm me kushtetutën dhe që Benxhamin Netanjahu kërkon të miratohet këtë muaj. Projektligji kontrovers e lejon shtetin që të autorizojë një komunitet të përbërë nga njerëz me të njëjtin besim fetar dhe kombësi që të ruajnë karakterin ekskluziv të komunitetit. Legjislacioni i propozuar, në formën aktuale, gjithashtu lejon implementimin e ligjit fetar hebraik në disa raste dhe eliminon arabishten si gjuhë zyrtare.

"Në demokracinë izraelite ne do të vazhdojmë të mbrojmë të drejtat e individit dhe të grupit, kjo është e garantuar. Por edhe shumica ka të drejta dhe shumica sundon", deklaroi kryeministri Netanjahu më herët.

Vota për ligjin pritet javën e ardhshme, megjithëse drafti final ende nuk është gati. Kritikët e kanë krahasuar ligjin me aparteidin në Afrikën e Jugut dhe protestat ndaj tij nuk kanë munguar. Kundër detajeve të ligjit janë shprehur edhe presidenti i vendit dhe Prokurori i Përgjithshëm. Kritikët thonë se ligji lejon krijimin e zonave të ndara bazuar në racë, fe apo kombësi dhe kjo është e papranueshme. Një pjesë e analistëve thonë se ligji me titullin Izraeli si 'komb shtet për popullin hebre' është mjaft i qartë në qëllimin e tij, ndërsa anëtarët e partisë "Likud" të Kryeministrit, kanë akuzuar Presidentin e Prokurorin e Përgjithshëm që kanë harruar ADN-në e tyre përderisa kundërshojnë ligjin.

SHBA i kërkon Turqisë të blejë raketat amerikane e jo ato ruse

Departamenti amerikan i Drejtësisë tha se është duke punuar për të bindur Turqinë, aleate në NATO, të blejë sisteme të mbrojtjes raketore nga SHBA-ja dhe jo nga Rusia. Tina Kaidanoë, ushtruese e detyrës së ndihmëssekretarit të Shtetit për Çështje Politike-Ushtarake, tha se zyrtarët amerikanë po bëjnë përpjekje t'i ofrojnë Turqisë sisteme Patriot.

Turqia ka tejkuluar sistemin Patriot dy herë gjatë procesit të përzgjedhjes, fillimisht duke



zgjedhur një sistem kinez, pastaj duke u kthyer kah sistemi S-400 rus. Drejtuesit e industrisë thanë se Turqia ka vlerësuar se blerja e

Patriotëve kërkon më shumë transferime të teknologjisë dhe se Uashingtoni nuk është i gatshëm t'i ofrojë.

Por, ndihmëssekretari i Mbrojtjes, Kevin Fahey, tha se Uashingtoni po bën më shumë përpjekje për të adresuar kërkesat e Turqisë.

"Turqia ka qenë e interesuar në sistemin Patriot, andaj po punojmë në këtë drejtim", tha ai.

Zyrtarët amerikanë dhe të NATO-s vazhdimisht i kanë thënë Ankarasë se sistemi rus i mbrojtjes raketore nuk mund të integrohet në sistemin ajror të NATO-s.

BE bën pakt me Japoninë, sfidon Trumpin

Bashkimi Europian dhe Japonia firmosën një marrëveshje më të mëdha të tregtisë në botë, e cila do të mbulojë gati një të tretën e GDP-së së globit dhe rreth 600 milionë vetë.

Ndër eksportet kryesore të bllokut në Japoni janë produktet e bulmetit, ndërsa makinat përbejnë zërin qendror të eksporteve japoneze.

Kjo lëvizje kontraktit thellë

me veprimet e administratës Trump dhe tarifave të diskutuara mbi importet e çelikut. Kreu i Komisionit Europian Jean Claude Juncker deklaroi se kjo është një marrëveshje, nga e cila përfitojnë të gjithë.

"Impakti i kësaj ujdije shkon përtej brigjeve tona. Së bashku, ne po bëjmë një deklaratë të fuqishme për të ardhmen e tregtisë së lirë e të ndershme.

Po tregojmë se jemi më të mirë dhe më të fortë kur punojmë bashkë dhe se ka diçka atje jashtë diçka më shumë se tarifave dhe barrierat", - u shpreh Juncker.

Shtetet e Bashkuara kanë qenë të përfshira në bisedime me Japoninë dhe vende të tjera aziatike përpara 18 muajsh mbi një marrëveshje të gjerë të Tregtisë së lirë, paktin tregtar të transpalesorit, por Donald Trump



zgjodhi të tërhiqej prej saj sapo mori në dorë frerët e presidencës amerikane.

Politika e tij "Amerika e Para" i

bëri punë në këtë rast Brukselit, sepse i hapi atij rrugën e nënshkrimit të këtij pakti me ekonominë e tretë më të madhe të botës.

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-3313/9 dt. 12.07.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit Detal Urbanistik për pjesë të BU 57 (57a), KK Tetovë 1

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e Përsëritur të **Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit Detal Urbanistik për pjesë të BU 57 (57a), KK Tetovë 1, komuna e Tetovës** me nr. teknik 11-1/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë, Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr "Ilindenit (Marshall Tito)", rr. "Video Smilevski Bato", rr. „29 Nëntori“, dhe rr. „A“.

Përfshirja është me sipërfaqe prej 7.1 ha.

Brenda përfshirjes planore të Planit Detal Urbanistik për pjesë të BU 57 (57a), KK Tetovë 1, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A2 - banim në ndërtesa kolektive, B2-Njësi të mëdha tregtare, B4 - institucione shtetërore, E2 - Suprastrukturë komunale, E1 - Infrastrukturë komunale.

ANKETA PUBLIKEE PËRSËRITUR të Propozim Planit Detal Urbanistik për pjesë të BU 57 (57a), KK Tetovë 1, komuna e Tetovës, do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 24.07.2018 – 30.07.2018 vjet.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIK I PËRSËRITUR të Propozim Planit Detal Urbanistik për pjesë të BU 57 (57a), KK Tetovë 1, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 25.07.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr.20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Planit Detal Urbanistik për pjesë të BU 57 (57a), KK Tetovë 1, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-3312/12 dt. 02.07.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 Tetovë

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, komuna e Tetovës me nr. teknik 11-3/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë, Periudha planore 2017-2022.**

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Vidoe Smilevski Bato", rr. "Vidoe Smilevski Bato 1", rr., "Vidoe Smilevski Bato 2", dhe rr., "Vëllezërit Miladinov".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 4.43 ha.

Brenda përfshirjes planore të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, A2 - banim në ndërtesa kolektive, D1 - Park për gjelbërim, E2 - Suprastrukturë komunale, E1 - Infrastrukturë komunale.

ANKETA PUBLIKE E PËRSËRITUR sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, komuna e Tetovës, do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 24.07.2018 – 30.07.2018.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIK I PËRSËRITUR sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 25.07.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 i Ligjit për marrëdhënie pune "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 134/16), dhe në bazë të Deklaratës për themelimin të Shoqërisë tregtare Naftovod SHPKNJP Shkup, Drejtuesi i shoqërisë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim në Naftovod SHPKNJP Shkup:

- Udhëheqës i sektorit Financa, 1 (një) realizues, për kohë të pacaktuar.
Kualifikimet e nevojshme
- Arsimit sipëror, Fakulteti ekonomik,
- njohje të gjuhës angleze,
- punë me kompjuter,
- Krahas kushteve të përgjithshme të parapara në Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët për vendin e punës nga pika 1 e kësaj shpallje është e nevojshme që të përmbushin edhe kushtet e posaçme, edhe atë:
- Certifikatë të shtetësisë
- Orari ditor i punës: prej ora 08:00/08:30 deri në ora 16:00/16:30.
- Orari javor i punës: 40 orë.
- Orari i kohës së punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte.
- Neto pagesa për vendin e punës për të cilin kërkohet punëtori është: 35, 400 denarë.
- Së bashku me kërkesën kandidatët duhet të parashirojnë dëshmi për kualifikim.
- Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët e parashirojnë në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter.
- Afati për paraqitje të kandidatëve zgjatë 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 45 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve.

Dokumentet parashirohen në adresën e Naftovod SHPKNJP Shkup, rruga 50 Divizija 26/3-5, telefoni 025116 303, personi për kontakt: Bojana Vasilevska

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrua pas afatit nuk do të merren parasysh.



JY MUZEJ NA ГРАД СКОПЈЕ – СКОПЈЕ
IP MUZEU I QYTETIT TË SHKUPIT - SHKUP

Në bazë të nenit 3 dhe nenit 20 – g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dh 35/2018), Rregullores për sistematin e vendeve të punës në Institutin publik "Muzeu i Qytetit të Shkupit" – Shkup, dhe në pajtim me pëlqimin për punësimet të dhënë nga Qyteti i Shkupit me nr. 08-5017/1 të datës 06.06.2018, Drejtori i Institutin publik "Muzeu i Qytetit të Shkupit" – Shkup, shpall

KONKURS PUBLIK nr. 01/2018

për punësim në kohë të pa caktuar

Institucionin publik "Muzeu i Qytetit të Shkupit" – Shkup shfaq nevojën për themelimin e marrëdhënieve të punës në kohë të pa caktuar për 2 (dy) realizues në vendet vijuese të punës:

I. Kustos për hulumtime inter - disiplinore – Seksioni për arkeologji
KUL/03/04/D03/002 – 1 realizues

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshtrës në Republikën e Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive ta shfrytëzojë gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës madhore;
- Të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- Arsimit sipërorë (niveli VII/1 ose së paku 240 EKTS) – Shkenca për letërsi
- Me ose pa përvojë pune;
- Njohja e një prej gjuhëve të cilat më shpesh shfrytëzohen në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, frënge dhe gjermane).

Orari i punës dhe shuma e pagës:

- Orë të punës në javë: 40
- Ditët e punës: nga e hën deri të premten
- Orari i punës: 08:30 – 16:30
- Paga neto: 20.335,00 denarë

II. Udhëheqës – Seksioni për marketing dhe edukim

KUL/03/04/D03/007 – 1 realizues (në depandanset e Muzeut – Punëtoritë ilegale gjatë kohës së LNC-së dhe në Suli Han)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshtrës në Republikën e Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive ta shfrytëzojë gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës madhore;
- Të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- Arsimit sipërorë (niveli VII/1 ose së paku 240 EKTS) – Shkenca e historisë, Historia e artit ose Shkenca e letërsisë;
- Me ose pa përvojë pune;
- Njohja e një prej gjuhëve të cilat më shpesh shfrytëzohen në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, frënge dhe gjermane).

Orari i punës dhe shuma e pagës:

- Orë të punës në javë: 40
- Ditët e punës: nga e diel deri në ditën e diel
- Orari i punës: nga e marta deri të premten nga ora 10:00 – 17:00; të shtunën nga ora 09:00 – 17:00; dita e diel nga ora 09:00 – 13:00
- Paga neto: 19.137,00 denarë

Kandidatët e interesuar për dy vendet e punës duhet të dorëzojnë këto dokumente në origjinal ose kopje të verifikuar nga noterit:

- Fletëparaqitja dhe biografia e shkurtër;
- Dëshmi për përfundimin e arsimit përkatës (Diploma ose Vërtetimi);
- Dëshmi për njohjen e gjuhës (certifikatë të pranuar në suaza ndërkombëtare e dhënë nga testuesi zyrtar evropian, anëtarë i Shoqërisë ALTE të testuesve evropian, ose vërtetimin nga institucioni ndërkombëtar për nivelin A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Aptis, ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCB, TEF, ose certifikata Gete);
- Vërtetimi për nënshtrësi.

Konkursi publik zgjat 10 ditë nga dita e shpalljes së shtypit ditor. Përzgjedhja do të realizohet më vonë në afat prej 30 ditëve nga dita e skadimit të afatit për paraqitje. Kandidatët e radhitur në pozita më të larta do të ftohen për testime dhe intervistë. Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë nuk do të shqyrtohen.

VËREJTJE: Në pajtim me Planin vjetor për punësim në institucionin për vitin 2018, punësimet janë të parapara për: Shqiptarë/shqiptare; Romë / Rome ose Serb / Serbe.

Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për punësim, do të zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe përkatës të qytetarëve të cilët i përfaqësojnë të gjitha bashkësitë etnike në Republikën e Maqedonisë, duke mos i cenuar kriteret e profesionalitetit dhe të kompetencave.

Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme, të dorëzohen deri te arkivi i Muzeut ose në adresën vijuese: IP MUZEU I QYTETIT TË SHKUPIT – Shkup, bul. Qirili dhe Metodit p.n. në Shkup (me shenjë: për konkursin me nr. 01/2018) më vonë deri në ditën e përfundimit të afatit të paraparë për paraqitje në lidhje me konkursin publik.

Kontakti: mgs@mgs.org.mk; pravnamgs@gmail.com ose 02/3227388, 02/3115367

Personi për kontakte: Biljana Trenevskva.

JANG BOJSI HUAZON SEFERIN TE VINERTURI

SHPRESOJ T'IA FILLOJ ME KËMBË TË MBARË

"Shpresoj të filloj me këmbë të mbarë si unë poashtu edhe shokëve të skuadrës. Pres dhe shpresoj në një sezon të mirë dhe të suksesshëm si në aspektin individual poashtu edhe në atë kolektiv", pohon Seferi

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 17 korrik - Sulmuesi i Kombëtares U-2, Taulant Seferi është huazuar sërish nga ekipi i tij Jang Bojs, që milton në elitën e futbollit zviceran. Futbollisti nga Kumanova ishte huazuar një vit më parë te skuadra e Vohlen në Ligën e Dytë të Zvicrës, ndërsa klubi verdhezi ka preferuar ta huazojë sërish sulmuesin 21-vjeçar te skuadra e Vintertur, po në Ligën e Dytë të Zvicrës. "Taulant Seferi (21 vjeç) vjen në huazim nga 'Seiss Master BSC Young Boys' për një sezon. 21-

vjeçari luan si mesfushor e majtë, por që mund të luajë gjithashtu si lojtar qendror dhe në të djathtë. Në sezonin e fundit, ai shënoi 15 gola në tre sezonet e kaluara. Në të kaluarën ka qenë anëtar i përfaqësueses së Maqedonisë, por tani luan për shpresat e Kombëtares së Shqipërisë. Te Vinerturi do të mbaj fanellën me numër 17. Ne i dëshirojmë mirëseardhje Taulant Seferit në Vintertur dhe shumë suksese", thonë nga klubi zviceran.

Derisa, i lumtur me transferimin e tij te Vinerturi është shprehur edhe vet Seferi. "Normali-

sht se jam shumë i lumtur për këtë transferim. E dimë se në Vintertur kanë luajtur shumë lojtar të njohur dhe është një klub shumë profesional dhe më është përshtatur shumë mua", u shpreh për gazetën KOHA Seferi, i cili tregon se si ka ardhur deri te realizimi i këtij transferimi. "Ka qenë vetë skuadra e Vinterturit, drejtuesit e së cilës kishin shprehur interesim për mua para tre muajve. Këtë ma ka konfirmuar drejtori i Jang Bojsit dhe menaxherët e mi, të cilët gjithashtu janë pajtuar për tu realizuar kjo lëvizje", shtoi më tej futbollisti nga



Kumanova. Në fund Seferi foli edhe për pritjet e tij te klubi i ri. "Shpresoj të filloj me këmbë të mbarë si unë poashtu edhe shokëve të skuadrës. Pres dhe shpresoj në një sezon të mirë dhe të suksesshëm si në aspektin individual

poashtu edhe në atë kolektiv", përfundoi deklaratën e tij për gazetën KOHA, Taulant Seferi. Sulmuesi kumanovar do të mbajë numrin 17 në fanellë, ndërsa sezonin që kaloi shënoi tre gola në 15 ndeshje me ekipin e tij.



Shuhen shpresat për Grezdën

Eros Grezda vijon të ketë probleme me kyçin e këmbës. Ishte parashikuar të ishte gati për ndeshjet e turit të dytë (26 korrik-2 gusht) në "Europa League", por për anësorin e kombëtares koha e rikuperimit do të zgjatë edhe më shumë. Futbollisti 23-vjeçar humbi fazën përgatitore dhe duket se vetëm nëse kalohet në fazën e grupeve mund të aktivizohet në Evropë me kroatët. Lajmet e fundit që vijnë nga Kroaci janë që Grezda do të duhet edhe rreth një muaj të nisë përgatitjet, çka do të thotë se do të jetë i gatshëm për Osijekun vetëm për sezonin e ri futbollistik. Gjakovari është një mungesë e rëndësishme për kroatët, por edhe në aspektin personal është një minus ky qëndrim jashtë fushave të blerta, pasi kishte mundësinë të luante në kualifikueset e "Europa League" dhe të shitej në një kampionat më të fortë. Gjithsesi cilësitë e tij dihen dhe janë disa klubet që e duan, por Osijeku do 2-3 milionë euro për kartonin e tij. Grezda pritet që të jetë gati për ndeshjet e Shqipërisë në muajin shtator. Kuqezinjët përballen me Izraelin dhe Skocinë më 7 dhe 10 shtator. E para luhet në shtëpi, kurse tjetra në transfertë.

XHAKA DEL SE NUK KA SHTETËSI TË DYFISHTË

Është vetëm zviceran

Derisa Sekretari i Përgjithshëm i Federatës futbollistike të Zvicrës, Aleks Miesher, kishte pohuar se në Përfaqësuesen zvicerane duhet të shqyrtohet mundësia që në të ardhmen t'u ndalohet pjesëmarrja shtetasve të dyfishtë, pas aferës së festimit me shqiponjë të Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit, federata kishte kërkuar falje të premtën që lamë pas për këtë deklaratë. Por, ky debat nuk po merr fund. Siç shkruan "SonntagsZeitung", lojtari i Zvicrës, Granit Xhaka, me prejardhje nga Kosova, ka vetëm pasaportë të Zvicrës. Ndonëse Federata Zvicerane e Futbollit ka thënë se Xhaka ka edhe pasa-

portë shqiptare, ky duket të jetë lajm i rremë, transmeton "Blick". Ai asnjëherë nuk ka pasur pasaportë të Shqipërisë e as të Kosovës. Madje as kombësi të njëjës nga këto dyja. Këtë e ka konfirmuar edhe avokati dhe këshilltari i Xhakës, Andre Gross. Me sa duket, kjo informatë e gabuar ka ardhur nga një listë, të cilën lojtarët e kishin plotësuar më 2015. Në atë listë, Xhaka deklaroi se kombësia e tij e dytë është ajo kosovare. Se nga i ka ardhur informata Federatës se ai ka pasaportë shqiptare, nuk dihet.

Edhe Xhaka kohë më parë e përshkroi veten si person me shtetësi të dyfishtë kur u sulmua në



një intervistë nga sekretari i FFZ-së, Alesk Miesher. Miesher kishte propozuar që në të ardhmen t'u ndalohet lojtarëve me shtetësi të dyfishtë të paraqiten për përfaqësuesen e Zvicrës. "Më ka zhgënjyer mua dhe të tjerët me shtetësi të dyfishtë", kishte thënë Xhaka. Mirëpo, këshilltari Gross thotë se Graniti nuk ka shtetësi të dyfishtë. Sipas një hulumtimi të

"SonntagsZeitung", as në ambasaden shqiptare në Bernë nuk ekziston ndonjë Granit Xhakë i lindur më 1992. Gazeta zvicerane, siç shkruan Koha.net, thotë se mbetet mister çështja e shtetësisë së dyfishtë për Xherdan Shaqirin e Valon Behramin. Sipas të dhënave të FFZ-së, edhe ata duket të kenë pasaporta shqiptare. Por, dyshimet janë të mëdha.

MEMUSHAJ I LUMTUR ME RIKTHIMIN TE PESKARA

Nuk më intereson shiriti i kapitenit, dua të luaj futboll

Pas një sezoni mjaft negativ te Benevento, Ledian Memushaj kthehet në shtëpi. Peskara duket ambienti ideal për mesfushorin vlonjat, i cili në periudhën 2014-2017 ishte një lider në ekipin abrucez, duke u larguar vetëm sepse pas një viti në Serinë A, dëshiron të qëndronte aty. Tashmë 31-vjeçari ka realizuar dëshirën e tij, kthimin në Peskara, ku shpreson vetëm të luajë futboll. Si një lider i vërtetë, Memushaj nuk shqetësohet shumë nëse nuk do të jetë kapiten, ndërsa në intervistën dhënë kanalit "Rete8", ka elozhe për Brugman, kapitenin aktual. "E vërtetë, Peskara më ka munguar

shumë. Jo rastësisht, edhe kur isha te Benevento sapo gjeja mundësinë vija në Peskara. Më ka marrë malli edhe të luaj futboll. Kam kaluar tre vite në Peskara, dy të parët ishin shumë pozitivë, i treti jo, ndaj sapo mu krijua mundësia, vendosa të kthehem me çdo kusht", u shpreh Memushaj, të cilit megjithatë nuk do ti kthehet shiriti i kapitenit. "Brugman është kapiteni. Është një djalë i jashtëzakonshëm, shumë i zoti për Serinë B dhe nëse qëndron, do të më pëlqente shumë të luaja me të. Jam krenar që është ai kapiteni, sepse ka gjithçka për të bërë mirë", tha Memushaj. Me trajnerin Zeman nuk



shkoi gjithçka shumë mirë: "Për fat të keq, janë metodat e Zemanit, i cili nuk sheh askënd në fytyrë, edhe nëse luan mirë. Ne vinim nga

një sezon i keq, ndoshta kisha frikë përsëritjen e atij sezoni, ndaj kur erdhi oferta nga Benevento në Serinë A, vendosa të shkoj atje, edhe pse e kisha kokën pas. Ishte një sezon shumë i veçantë", vazhdoi më tej Memushaj. Në fund futbollisti shqiptar ka folur për synimet e Peskarës. "Duhet të ëndërojmë diçka të madhe dhe është bukur që të synojmë Serinë A. Seria B ka treguar se nuk ka skuadra që e fitojnë kampionatin me lehtësi, këtë vit do të jetë edhe më e ekuilibruar, sepse sipas meje ka më pak skuadra të ashtuquajtura 'vrasëse kampionati', me skuadra më të forta se të tjerët", përfundoi Memushaj.

Shifrat e të ardhurave të Barcelonës rezultuan me një fitim operativ prej 32 milionë euro dhe një fitim neto prej 13 milionë euro. Shifrat janë në përputhje me planin strategjik të klubit për arritjen e 1 miliard eurove të ardhura në vitin 2021. Vitin e kaluar, Barcelona arriti të ardhura prej 708 milionë euro, shumë e cila ishte rekordi i mëparshëm

Barcelona njoftoi të ardhura rekord si klub, me bordin e drejtorëve që mbyllën llogaritë korresponduese të sezonit 2017-2018 në kuotën e 914 milionë eurove. Në fushë, katalanasit patën shumë sukses në La Liga, duke rikthyer titullin në sezonin 2017-2018, pas një viti zhgënjyes, që i kishte parë ata të hiqnin dorë nga kurora përballë rivalëve të Real

900 MILIONË EURO TË ARDHURA NË SEZONIN E KALUAR

BARCELONA NË MAJËN E TOP-KLUBEVE



Madrid. Sezonin e kaluar edhe pse një humbje ndaj Levan-tes, në ndeshjen e parafundit, ia mohoi këtë nder. Gjithsesi, sku-

dra e Valverde vendosi rekorde në fushë, duke mbajtur ecurinë më të gjatë si e pamposhtur në

Madrid. Sezonin e kaluar edhe pse një humbje ndaj Levan-tes, në ndeshjen e parafundit, ia mohoi këtë nder. Gjithsesi, sku-

një sezon, në historinë e La Ligas. Dhe tani, klubi po vendos rekorde jashtë fushe. Shifrat e të ardhurave të Barcelonës rezultuan me një fitim operativ prej 32 milionë euro dhe një fitim neto prej 13 milionë euro. Shifrat janë në përputhje me planin strategjik të klubit për arritjen e 1 miliard eurove të ardhura në vitin 2021. Vitin e kaluar, Barcelona arriti të ardhura prej 708 milionë euro, shumë e cila ishte rekordi i mëparshëm. Klubi do të paraqesë detaje shtesë të shifrave të fundvitit, si dhe buxhetin e ri, përpara takimit të ardhshëm të përgjithshëm. Bordi i drejtorëve shprehu gjithashtu urimet e veta për Samuel Umtiti dhe Ousmane Dembele, për arritjet e tyre me Francën, si fituesit e Kupës së Botës 2018.

Publicitet

Në bazë të nenit 21, paragrafi 2, e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra për punë sociale Demir Hisar publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të pacaktuar në IP Qendra për punë sociale Demir Hisar

1. Psikolog – niveli A6 në Shërbimin për shërbime nga mbrojtja sociale1 (një) realizues
2. Jurist - niveli A6 në Shërbimin për shërbime nga mbrojtja sociale1 (një) realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra për punë sociale Demir Hisar:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra për punë sociale Demir Hisar:

- Për vendin e punës me numër rendor 1 (një):
- 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit, fakulteti filozofik psikologji, pa ose me së paku 1 vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,

Për vendin e punës me numër rendor 2 (dy):

- 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit, fakulteti juridik drejtimi studimet juridike, pa ose me së paku 1 vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,

Kandidatët duhet të parashtojnë dokumentet në vijim (në original ose kopje të vërtetuara në noter):

1. Certifikatë/diplomë për arsim të mbaruar;
2. Certifikatë të shtetësisë;
3. Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
4. Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
5. Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
6. Biografi të shkurtër;
7. Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: 40 orë të punës në javë, koha e punës fleksibile prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07:30/08:30 deri në ora 15:30/16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë për secilin vend pune është 23,181,00 denarë. Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar të punës.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra për punë sociale Demir Hisar, ose përmes postës në adresën në vijim: rr. "Marshall Tito" pn (me shenjë "për shpallje publike").

Personi për kontakt: Dimçe Mitrevski, tel. 078-294 271.

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

IP Qendra për punë sociale
Demir Hisar



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor



MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesën për dhënie e lejes për kaptazhin dhe përdorimin e ujit nga një trup nëntokësor për qëllime teknologjike..

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për ujëtarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor iu dorëzua Kërkesa për kaptazhin dhe përdorimin e ujit nga ujëtarë nëntokësor për nevojat teknologjike për sistemin e pompave ngrohëse për ngrohjen dhe ftohjen e Qendrës Sportive

Parashtruesi i kërkesës :

Qendra Sportive Jane Sandanski
rr: Asnom nr.1

1000 Shkup

Puset ndodhen në KK Kisella Voda 2 me këto koordinata:

Pusi	P.K	X	Y	Z
EB-1	44/6	4 649 947	7 539 009	240
EB-2	43/2	4 650 072	7 539 018	241
EB-3	44/6	4 649 960	7 538 905	240
EB-4	43/3	4 650 049	7 538 895	239
EB-5	43/3	4 650 081	7 538 932	239

Uji i shfrytëzuar kthehet në një pusët kulimi të bërë në tokë të PK 43/3 me koordinata:

X= 4 650 123; Y=7 539 018

Informacion rreth kërkesës, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail b.apostolova@moepp.gov.mk

Publiku i tanguar, brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë të paraqesë mendime dhe komente me shkrim në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në bulevardin "Goce Delçev" Nr.18 në ndërtesën e RTM (kati 10), 1000 Shkup

I nr. 1823/2017

SHPALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përmbarim "Gazeta Zyrtare" nr. 72 e datës 12.04.2016)

Përmbareuesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përmbareues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaedin Dauti – Gostivar, kundër borxhlinjve 1. Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë 2. Gjurmazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, 3. Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikola Parapunov nr. 236, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 13.07.2018:

FTON

Borxhlinjtë Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Gjurmazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë për shkak të dorëzimit të:

-Procesverbalit për shitje të patundshmërisë përmes ankandit publik me gojë në bazë të nenit 186 paragrafi (4) të LP I nr. 1823/2017 të datës 26.06.2018

-Konkluzion për shitjen e dytë publike me gojë në bazë të nenit 179 paragrafi (1), nenit 181 paragrafi (1) dhe nenit 182 paragrafi (1) e LP P. nr. 1823/2017 të datës 04.07.2018.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit.

PARALAJMËROHEN borxhlinjtë Xhezmi Emro, Gjurmazije Emro, Fatime Emro, se mënyra e këtillë e parashtrimit konsiderohet si e dorëzimi i rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

KJO PARAQET SHPALLJEN E DYTË.

Përmbareues
Aleksandar Kuzmanovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

KRISTIANO RONALDO FLET PAS TRANSFERIMIT TE JUVENTUSI

S'KAM ARDHUR KËTU ME PUSHIME, DO T'JU BEFASOJ

"Nuk jam aspak i mërziur. Jam te një klub i madh me lojtarë të mëdhenj. Kam falënderuar Juventusin për mundësinë që më ka dhënë", u ka thënë gazetarëve italian Ronaldo

Pasi vizitat mjekësore u mbyllën me sukses, ku nuk pati asnjë problem fizik apo shëndetësor pas një sezoni të gjatë, Cristiano Ronaldo tani është gati të zbresë në fushë për skuadrën e tij të re, Juventus, me të cilën pritet të luajë në 4 sezonet e ardhshme. Mijëra tifozë kanë shoqëruar këtë ditë të parë si Juventusin të KR7, që pasi ka përfunduar vizitat ka qenë në qendrën stërvitore të skuadrës bardhezi, ku ka takuar trajnerin Massimiliano Allegri dhe shokët e rinj të skuadrës. Me disa prej tyre njihet, natyrisht si rival, ndaj nuk kanë munguar përqafimet. Derisa, pasi është prezantuar si futbollist i ri i Joves, Ronaldo ka dhënë intervistën e parë për mediat italiane

– Si ndihesh?

Ronaldo: Jam shumë i përçatitur për këtë sfidë. Kam besim dhe besoj se gjërat do të shkojnë si në klubet e tjera ku kam luajtur.

– A je i mërziur për largimin nga Real Madrid?



Ronaldo: Nuk jam aspak i mërziur. Jam te një klub i madh me lojtarë të mëdhenj. Kam falënderuar Juventusin për mundësinë që më ka dhënë.

– A do të vazhdosh të luash më kombëtaren?

Ronaldo: Nuk do t'ia kthej kurrë krahët kombëtares, nëse do të ketë nevojë për mua.

– A ke ndonjë mesazh për tifozët e mërziur të Real Madrid?

Ronaldo: Siç thashë më parë, ka qenë një histori e jashtëzakonshme ajo që kam pasur me Real Madridin, një klub që më ka ndihmuar shumë. Falënderoj tifozët, por tani duhet të nis një kapitull të ri të jetës sime.

– Çfarë i thoni tifozëve të Juventus që ju kanë kërkuar Championsin?

Ronaldo: Do të kërkoj t'i tregoj italianëve se jam një lojtar shumë i mirë, por nuk mendoj se kam diçka për të treguar. Më

pëlqejnë sfidat, nuk jam asnjëherë i kënaqur me veten. Duhet të kesh edhe fat, por edhe duhet ta kërkesësh fatin. Edhe se 'Champions League' është një trofe që e duan të gjithë. Ekziston mundësia që ta fitojmë, por do të luajmë për të gjitha kompeticionet: Seria A, Champions, Kupa e Italisë. Çampioni është shumë i vështirë, siç e ka provuar vetë Juventusin në finallet e fundit. Shpresoj të kem fat dhe ta fitojmë.

– A kanë ndikuar te vendimi juaj duartrokitjet që keni marrë nga tifozët bardhezinj në ndeshjen e "Champions League" kundër Juventus?

Ronaldo: Ka qenë një moment shumë i bukur dhe special. Edhe pritja e sotme ka qenë shumë e bukur, motivuese për të ardhmen. I falënderoj për gjithçka.

– A e dije që do të vije tek Juventusin në përfundim të finalës së "Champions League"?

Ronaldo: Nuk kisha vendosur akoma asgjë. Nuk mendoja se do të vija te një klub kaq i madh. Falë presidentit Anjeli dhe gjithë klubit që kanë menduar për mua. Jam mirë fizikisht dhe emocionalisht. Kjo etapë e re është një motivim i madh për mua.

– A keni pasur oferta të tjera?

Ronaldo: Jo, ka qenë e vetmja

– Kur do të vijë debutimi me Juventus?

Ronaldo: Do të filloj të stërvitem me 30 korrik. Dua të luajë në ndeshjen e parë të kampionatit.

– A do të shkosh te Sporting në përfundim të kontratës me Juventus?

Ronaldo: Sporting është një skuadër shumë e rëndësishme për mua. Ajo që dua është të fitoj me Juventusin, nuk kam ardhur këtu me pushime. Do të kërkoj t'ju befasoj të gjithëve.

AJME SHKURT

Manxhukij nuk preket

E ardhmja e Mario Manxhukij do të vazhdojë të jetë bardhezi. 32-vjeçari i cili zhvilloi një botëror të jashtëzakonshëm me Kroacinë duke u renditur të dytë, konsiderohet shumë i rëndësishëm për projektet afatgjata të Juventusit. Pavarësisht ofertave të shumta nga skuadrat angleze dhe ato gjermane në drejtim të sulmuesit, "Zonja e vjetër" i ka refuzuar të gjitha me kërkesë të trajnerit Allegri, i cili e shikon kroatin një pikë të fortë në sulm.

Monako konfirmon ofertën për Golovin

Monako ka konfirmuar se do të konkurrojë Juventusin dhe Çellsin për Aleksandr Golovin. Fantazisti rus ka qenë subjekt i një interesi të madh nga klubet e mëdha evropiane, por deri tani asnjë klub nuk ka përmbushur kërkesat ekonomike të CSKA-së së Moskës. "Kemi bërë një ofertë për Golovin, një ofertë mjaft bujare dhe kemi ofruar një kontratë pesëvjeçare për lojtarin. Mendoj se një tranzicion me një klub si Monako do të ishte opsioni më i mirë për të në këtë fazë të karrierës. "Gjithçka duhet të vendoset në ditët e ardhshme, mbase edhe sot. Nuk mund të presim më gjatë. Nëse nuk ndodh, do të shohim opsione të tjera", ka konfirmuar zv.presidenti i Monako-s Vadim Vasiliev.

Blind rikthehet sërish te Ajaksi

Pas katër vjetësh në "Old Trafford", Dalej Blind mbyll aventurën me Manchester Junajted. Mbrojtësi holandez do të rikthehet në vendlindje, te skuadra e Ajaksit. Drejtuesit e "Djajve të kuq" kanë arritur marrëveshjen me harkëtarët për transferimin e futbollistit, pikërisht në klubin ku është formuar. Sipas mediave angleze, kanë mbetur edhe pak gjëra për t'u rregulluar në kontratën e 28-vjeçarit, por zyrtarizimi i tij te skuadra e drejtuar nga Erik ten Hag është thjesht çështje kohe. Blind kaloi te "Djajtë e kuq" në verën e vitit 2014 dhe për 4 sezone luajti 90 takime me Manchesterin, duke gjetur 4 herë rrjetën.

PSZH-ja në sulm për Rousin

Paris Sen Zhermen piketon Danny Rous të Totenemit për të përforcuar krahnin e majtë të mbrojtjes. Vështirësitë që po hasin drejtuesit e klubit parisien në trativat me Juventusin për të arritur te Aleks Sandro, detyruan trajnerin e francezëve Tuçel të interesohet për 28-vjeçarin e "Spursave". Gjithsesi për të arritur te Rous, klubi nga Parisi më parë duhet të mposhtë konkurrencën e Junajted, që ka kohë në ndjekje të futbollistit. Kartoni i mbrojtësit të përfaqësueses angleze kushton rreth 25-30 milionë euro.

Donnarumma te Roma nëse ikën Alison

Portieri brazilian Alison mbetet dëshira e shumë skuadrave të mëdha në Evropë, por Roma nuk ka ndërmend ta lërë të lirë 25-vjeçarin pa gjetur më parë zëvendësuesin e duhur. Ndaj dhe drejtuesit e klubit verdhekuq janë në bisedime me portierin e kombëtares italiane Gjigji Donnarumma, për ta sjellë në kryeqytet sezonin e ardhshëm. Roma është gati të përdorë të gjitha paratë që do të arkëtojnë nga shitja e portieri brazilian për të marrë 19-vjeçarin Donnarumma, që duket se e



shih qëndrimin në Serinë A si një zgjidhje optimale edhe për faktin se do të luante në "Champions League" sezonin tjetër. Alison ka pasur kërkesa që para Botërorit "Rusi 2018", kryesisht nga Premier Ligë, me Liverpuln në "pole" për ta marrë dhe

paratë që "reds" ofrojnë për të janë të mjaftueshme për të sjellë Donnarumma në "Olimpico". Për këtë arsye, drejtuesit e Romës po bisedojnë me menaxherin e talentit 19-vjeçar Mino Raiola rreth mundësisë së transferimit të tij te verdhekuqtë. Skuadra e trajnerit Di Francesco favorizohet edhe nga fakti se Milani nuk do të luajë në Evropë sezonin tjetër, madje kuqezinjët kanë nevojë për parë pas pezullimit nga UEFA dhe portieri mund të jetë i sakrifikuari.

16 tituj, që formojnë rekordin e një lojtari, i cili është vetëm 25 vjeç. Ky është "plamaresi" i Rafael Varane, një mbrojtës, i cili ka hyrë në historinë e Real Madridit dhe, që nga 16 korriku 2018, edhe të Francës. Me "pushtimin" e Ruisë, pas fitores në finale ndaj Kroacisë, francezi vetëm e ka rritur "legjendën" e tij

Katër Çampions, tre Botërorë për Klubet, tri Superkupa Evropiane, dy La Liga, një Kupë Mbreti, dy Superkupa Spanjolle dhe një Kupë Bote. 16 tituj, që formojnë rekordin e një lojtari, i cili është vetëm 25 vjeç. Ky është "plamaresi" i Rafael Varane, një mbrojtës, i cili ka hyrë në historinë e Real Madridit dhe, që nga 16 korriku 2018, edhe të Francës. Me "pushtimin" e Ruisë, pas fitores në finale ndaj Kroacisë, francezi vetëm e ka rritur "legjendën" e tij. Një legjendë, që filloi ta shkruante në sezonin 2011-2012, kur ngriti trofeun e tij të parë: La Liga me 100 pikë. Më pas, ai ka fituar rregullisht trofe në konkurrencën e brendshme spanjolle, por edhe më gjerë. 233 ndeshje ka tashmë me fanellën e bardhë dhe 49 ndeshje me kombëtaren e Francës,

ASKUSH SI RAFAEL VARANE

16 TITUJ NË MOSHËN VETËM 25-VJEÇARE



më të cilën debutoi më 22 mars 2013. Gjërat kanë ndryshuar shumë që atëherë. Sepse tani, Varane është një pjesë e padiskutueshme në të dyja ekipet: Real Madridi dhe Franca. Një garanci e madhe në qendër të mbrojtjes. Ai ka luajtur 10 lojërë unike gjatë

gjithë karrierës së tij dhe i ka fituar të 10-ta. Çuditërisht, vetëm finalja e Kupës së Mbretit, që Atletico Madridi fitoi kundër Real Madridit (2012-2013) është e humbur për të. Më 17 maj 2013, francezi u plagos për një javë, ndaj u detyrua të tërhiqej nga sfida me Espanjol, për

një problem në gjurin e djathtë. Përveç kësaj, me "Les Bleus", ai gjithashtu nuk luajti në finalen e Kampionatit Evropian 2016, për shkak të një plaje në biceps-in femor të këmbës së tij të majtë. Portugalia fitoi 1-0 ndaj francezëve, në Paris.



15 ditë burgim për njërin tifoz që u fut në fushë

Një gjykatë në Moskë të hënën ka dhënë dënim me burgim prej 15 ditëve për njërin nga katër personat që u futën në fushë për të ndërprerë shkurtazi finalen e Kupës së Botës në futboll, të dielën, ndërmjet Francës e Kroacisë. Ata u futën pasi kishin veshur uniforma fals të policisë. Për të tjerët vendimi do të merret më vonë, shkruan Reuters. Gjykata po ashtu ia ndaloi Veronika Nikulshinas që të përcjellë ngjarje sportive në tre vjetet e ardhshëm. Futja në fushë e anëtarëve të bendit "Pussy Riot", është vlerësuar nga autoritetet ruse si një akt i pacipë i bërë në stadiumin "Luzhniki" në Moskë në prani të presidentit të Ruisë, Vladimir Putin. Olga Kuraçyova, një nga katër që u futën në fushë me uniforma të policisë, ka thënë se kjo manovër kishte për qëllim të promovojë lirinë e të folurit dhe të dënojë Federatën Botërore të Futbollit (FIFA). Mbrojtësi kroat, Dejan Lovren, që e shtyri njërin nga personat anash fushës, u ka thënë gazetarëve se incidenti ka ndërprerë lojën në një moment të rëndësishëm për skuadrën e tij. "Është mëkat që kemi penguar sportistët. FIFA është përfshirë në lojërë jo-fer për fat të keq. FIFA është mike e krerëve të shtetit që bëjnë shtypje dhe që shkelin të drejtat e njeriut", ka thënë Kuraçyova. Ndeshja, që është shikuar nga Putin dhe nga presidentët e Francës e Kroacisë, u ndërpre shkurtazi herët në pjesë të dytë, por vazhdoi pas 25 sekondave. Franca mposhti Kroacinë në finale me shifrat 4:2.

Krenar për "Këpucën e Artë"

Kapiteni i Anglisë Harri Kin ndihet krenar për fitoren e Këpucës së Artë por meritat ia ka dhënë shokëve të ekipit. Kane është shpallur golashënuesi më i mirë i turneut me 6 golat e shënuar, megjithëse nuk shënoi asnjëherë në fazën e nokautit. "Jam shumë krenar që kam fituar Këpucën e Artë të Botërorit. Nuk do të ishte e mundur pa shokët e ekipit dhe punës së madhe që bëhet në prapaskenë", deklaroi Kin. Tre nga golat janë shënuar me penallti, ndërsa tre të tjerët në lojë. Tani sulmuesi anglez do të shijojë disa ditë pushime me familjen e tij përpara se të rikthehet tek Totenhemi për një tjetër sezon të vështirë në Premier Ligë.



Pele "kërcënon" Mbappen

Të fitosh një Kupë Bote nuk është diçka që mund ta bëjnë të gjithë, aq më pak në moshën 19-vjeçare. Dhe nëse arrin të shënosh gol në finale, atëherë hyn në rekorde të rralla. Ja pra që Francë-Kroaci ka hyrë në historinë e rekordeve, me Kylian Mbappe protagonist autentik. Sulmuesi i PSG, në fakt në moshën 19 vjeç e 207 ditë është shënuesi i dytë më i ri që shënosh gol në një finale të Kupës së Botës, pas krahëve të më të madhit të të gjitha kohërave, Pele. Vetë "Mbreti", përmes një mesazhi në "Twitter", e ka përgëzuar asin francez, duke i uruar mirëseardhjen në klubin U-20. "Vetëm adoleshenti i dytë që shënosh gol në një finale të Kupës së Botës. Mirë se vjen në klub. Është bukur të kesh shoqëri", shkroi Pele, i cili në një tjetër postim "kërcënoi" francezin: "Nëse Mbappe do të vendoste të vendosë të vazhdojë të barazojë rekordet e mia, atëherë mundet edhe që të fshij sërish pluhurin nga këpucët e mia". Ndërkohë e menjëhershme ishte përgjigja e francezitet të datë-

lindjes 98: "Mbreti mbetet gjithmonë mbret". Në fakt Pele rezultoi të jetë futbollisti që ka shënuar në një finale Botërori në moshën më të re, vetëm 17 vjeç dhe 49 ditë.

Pele @Pele
Only the second teenager to have scored a goal in a #WorldCupFinal! Welcome to the club, @KMbappe - it's great to have some company! // O segundo adolescente a marcar um gol em uma final de #CopaDoMundo! Bem-vindo ao clube, Kylian - é ótimo ter a sua companhia!



FIFA World Cup @FIFAWorldCup
Teenagers to score in a #WorldCupFinal
* Pele
* Kylian Mbappe
That is all.

Zhirud i bën jehonë talljes së Anglisë nga Pogba

Olivier Zhirud thotë se ka jetuar një ëndërr fëmijërie, pasi fitoi Kupën e Botës me Francën. "Les Bleus" triumfuan me një fitore 4-2 ndaj Kroacisë, në finalen e së dielës. Një autogol i Mario Manxhukic, penalltia e Antoine Grizmann, Pol Pogba dhe Kylian Mbappe, e çuan Francën në fitimin e një kurore të dytë të Kupës së Botës, pas asaj të vitit 1998. Sulmuesi 31-vjeçar i dha fund kësaj gare pa shënuar dot asnjë gol, edhe pse luajti shtatë ndeshje në Rusi. Sidoqoftë, Zhirud i heshti kritikët e tij, duke ngritur trofeun në Moskë.



"Është një ndjenjë e madhe, dua të them se Kupa e Botës është duke ardhur në shtëpi (It's coming home)! Më duhet ta them këtë", bëri shaka Zhirud me gazetarët anglezë. "Sinqerisht, është një ëndërr e vërtetë, një ëndërr e fëmijërisë. Jam shumë krenar për të gjithë njerëzit që na kanë mbështetur. Ka qenë ndonjëherë e vështirë, çka ju e dini, por është një privilegj për mua të jem pjesë e këtij ekipi. Kemi qenë shumë solidë, shumë të fortë deri në fund dhe mendoj se e kemi merituar", deklaroi Zhirud.

DASHI 21. mars - 20. prill
Ky është një moment shumë i mirë për të pushuar dhe rikuperuar të gjithë ato raporte që gjatë kohëve të fundit kanë kaluar në plan të dytë për shkak të punës së tepërt. Nuk duhet të jeni të ndrojtur, por tregohuni më të hapur ndaj eksperiencave të reja.

DEMI 21. prill - 21. maj
Sa i takon dashurisë dhe ndjenjave ky është momenti për t'u marrë më shumë, sidomos nëse gjatë javëve të fundit këtë sektor e keni lënë pas dore. Në punë, mundohuni të rivendosni harmoninë, pasi një ambient i këndshëm, do ju lejojë që të përqendroheni më shumë.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Para jush hapen mundësi të mëdha, sidomos sa i takon raporteve në çift për të ardhmen. Duhet të jeni të gatshëm për të bërë zgjedhje të rëndësishme. Në vendin e punës mos u dekurajoni, për shkak se janë fare pranë propozime mjaft të rëndësishme.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Ka ardhur momenti për të treguar se sa dini që të jeni të vendosur dhe të pavarur, sidomos në vendin e punës. Në dashuri, këshillohet që të shmangni polemikat.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Intuita juaj e mirë do ju lejojë që të kapërceni çdo pengesë që do ju dalë përpara në karrierën tuaj. Në dashuri duhet të jeni më të hapur dhe spontan në raport me partnerin/en. Qetësia dhe besimi do të jenë të pazëvendësueshme.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Nëse në familje ka pasur tensione të vogla, mundohuni që të silleni me sa më shumë diplomaci dhe ti hapni rrugë dialogut. Gjetja e zgjidhjeve të mira për ju, nuk do të jetë e vështirë, por gjithsesi duhet të shmangni imponimin.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Zgjidhja e konflikteve në vendin e punës, nuk do të jetë e lehtë, por ju do të dini të veproni në mënyrën e duhur për të kapërcyer pengesat. Ka një afat i cili do ju tensionojë, por më në fund do ia dilni mbanë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Gjatë kësaj dite duhet të përballni me vendosmërinë e duhur, ndryshimet me të cilat do të përballeni, si në fushën e ndjenjave edhe në atë të profesionit. Do të riktheheni të jeni protagonist dhe do të merrni kënaqësi të shumta.


SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Ky është një moment shumë i mirë për tu marrë me pasione dhe projekte të vjetra, të cilët për shkak të mungesës së kohës nuk i keni vlerësuar më parë. Sa i takon një lidhje në çift, do të marrë një shtysë mjaft të rëndësishme.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Në dashuri këshillohet të mos tregoheni shumë xheloz, pasi tashmë është momenti për të shfaqur hapur ndjenja tuaja në raport me partnerin/en, sidomos nëse gjatë javëve të fundit keni qenë të zënë me punë. Në punë do të rezultoni të suksesshëm për shkak të forcës dhe vendosmërisë tuaj.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Parashikohet një ditë e cila do ju gjejë mjaft të tensionuar për shkak të keqkuptimeve të vogla në vendin e punës. Nëse do arrini të tregoni se e keni situatën nën kontroll, do të rezultoni të suksesshëm.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Nëse do të jeni gati të punoni fort dhe të bëni ndonjë sakrificë, kjo ditë parashikon rezultate të mëdha nga pikëpamja profesionale. Intuita nuk do ju zhgënjëjë dhe do të keni dëshirë për tu rikthyer në lojë. Ndërsa në dashuri, këshillohet që të jeni më të kujdesshëm.

Mensur Mamuti	TRASTA AKTORI SHQIPTAR NË FOTO, (VDIQ MË 16 KORRIK 2018)	TH	FILM ME AKTORIN NË FOTO	DREJTUES I NËJE MINISTRIE MBULESË FYTYRE (SH.)	M
FILOZOFI DHE HEROI KOSOVAR, AGANI					
ASOCIACIONI I SHTETEVE TE AZISE JUGLINDORE					
PARTNERI I PIKSIT (FILM VIZATIMOR)					
ITALIA		JUNGE KUNSTNERES SAMFUND AGU I MËNGJESIT, AGIMI			
ZBUKURIM NË NGJYRA TE NDRYSHME (SH.)					
PARA QË MERREN PER TI KTHYER PRAPE					
ARNOLD				RUMANIA FRIKË E MADHE (SH.)	
LLOJ					AI QË PUNON ARËN, BUJK
ERA E MIRË					QË I ËSHTË VENË TATIMI
KOHA	BANORE E SHBA-VË I PALËVIZSHËM, JO DINAMIK				FILM I AKTORIT NË FOTO KALIMI
SUEDIA		PEMË FRUTORE, MELEVËZHËGË TE FORTE (SH.) ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ, MAJKELL			OFFICE OF GLOBAL SERVICES NUMRI (SHKURT.)
ZEMËRGJERËSITË, LEJESAT					
AFRON (BISED.)				NUMËR NJËSHIFROR BASHKËSHORTE (SH.)	ENERGJIA KALI I SHALES
NGJYRA E LËKURËS XEHERORI				UDHËRRËFYESIT (HUAJ) EPOPE	
M					VEGËL MUZIKORE (SI MANDOLINA) AUSTRIA
KËRÇOVA			LLOJ PËRPARËSEJE PREJ LËSHI		



ZGJIDHJET: TH, M, FEHMI, ASEAN, DIKSI, I UKS, LARAT, HUATË, ARN, R, SORT, AROMA, M, AMERIKANE, S, ARRA, OGS, TOLERANCA, AVIT, TRE, E, TEN, GUIDAT, MINIERA, UTLI, KI, PARANIK.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

6	4	1		3			2										
							3					2	4	8			
					7	4				4	1	7		5	8	2	
2	6				3		9	4		6	3			1	2	4	
										9							5
		3	5	9			7	8		8	5	4			1	6	
			8	7				3		7	8	9		4	5	1	
5	9							6				5	3	6			
				4				9									

Shumë i lehtë: 641538927, 752194638, 983627451, 267853194, 819472365, 435916782, 128769543, 594381276, 376245819. Mesatar: 826319475, 537248691, 941765823, 763851249, 194672358, 285493167, 378924516, 419536782, 652187934.

Stacionit të metrosë i vendosin emrin e trajnerit të Anglisë



Një stacioni të metrosë më të famshme në Londër i kanë vendosur emrin e trajnerit Gareth Southgate, në shenjë përgëzimi për atë çka ai arriti me ekipin kombëtar të futbollit në Kupën e Botës Rusi 2018. Në fakt nuk i është dyshuar shumë punë-punëtorëve të mirëmbajtjes së metrosë, pasi emri origjinal i stacionit ishte "Southgate" dhe ata i kanë shtuar vetëm emrin "Gareth" përpara. Ky është një stacion në veri të Linjës Picadilly, dhe mësohet se emri i ri do të qëndrojë vetëm për 48 orët e ardhshme.



George Clooney, aktori më i paguar

George Clooney fitoi para vitin e kaluar më shumë se çdo aktor tjetër brenda një periudhë 12-muajshe, pjesërisht falë shitjeve të kompanisë së tekuilas që ai bashkëthemeloi. Revista Forbes vlerësoi se ylli amerikan, 57 vjeç, ka fituar 239 milionë dollarë fitime pa taksa në periudhën nga 1 qershori 2017. Me këtë shumë, Clooney radhitet i dyti në listën vjetore të Forbes për celebritet më të paguar në botë, menjëherë pas boksierit Floyd Mayweather. E treta është Kylie Jenner, personalitet amerikan televiziv, modele dhe sipërmarrëse. Grupi muzikor U2 përfshihet po ashtu në dhjetëshen e parë, së bashku me futbollistët Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo.

SUNION, qepa që nuk shkakton lotim dhe erë të keqe të gojës

Sunion tashmë gjendet në tregun amerikan, dhe janë konfirmuar deklaratat e shkencëtarëve që ajo nuk shkakton lot dhe nuk lë erë të pakëndshme në gojë, ndërkohë që ka ruajtur të njëjtën shije



Nëse keni përgatitur ndonjëherë qepë në kuzhinë, atëherë e dini se kjo është një nga punët më të vështira të kuzhinës. Të gjithë kuzhinierët pajtohen për një gjë, dhe kjo është se sytë çdo herë lotojnë kur presin qepë, dhe përveç bartjes së syzeve mbrojtëse, deri më tani nuk ka pasur zgjidhje adekuatë. Megjithatë, shkencëtarët dhe fermerët nga Shtetet e Bashkuara kanë dalë me zgjidhje për këtë problem, i cili për dekada të tëra po i mundon kuzhinierët dhe me forca të përbashkëta e kanë prodhuar një qepë e cila nuk shkakton lot, përcjell Washington Post.

Produkti i ri është quajtur Sunion dhe është rezultat i një gërshetimi natyral të disa llojeve të qepëve, në të cilin shkencëtarët kanë punuar në fermat në Nevada dhe Washington që nga viti 1980. Krijuesit e perimes së re theksojnë se konsumatorët nuk duhet të shqetësohen për cilësinë e saj, sepse kjo bimë i përmban të gjitha shijet, si qepët e zakonshme, përveç se nuk shkakton lot gjatë përgatitjes dhe është eliminuar era e pakëndshme e cila mbetet pas konsumimit të qepës së zakonshme. Tek prerja e qepës së zakonshme lirohen enzimet, të cilat e prodhojnë gazin sin-propantial-S-ok-

sid. Kur arrihet te sytë prodhohet acidi i butë sulfurik, i cili shkakton djegie. Derisa mbarsat nervore e njohin një reagim të tillë si rrezik, trurit i dërgohet sinjali nga i cili rrjedhin lotët mbrojtës. Ajo që është interesante është se nga qepa e zakonshme këto substanca bëhen më të forta nëse qepa është ruajtur më gjatë, ndërsa edhe kuzhinierët pajtohen me këtë të dhënë.

Te produkti i ri, qepa Sunion, ky fenomen është neutralizuar krejtësisht dhe sa më gjatë që qëndron e ruajtur, efekti i lotëve në sy është gjithnjë e më i vogël. Sunion tashmë gjendet në tregun amerikan, dhe janë konfirmuar deklaratat e shkencëtarëve që ajo nuk shkakton lot dhe nuk lë erë të pakëndshme në gojë, ndërkohë që ka ruajtur të njëjtën shije. Disa prej tyre vunë në dukje se ajo ishte aq e shijshme sa që mund të konsumohej si kokoshka.

Për fat të keq, për dashamirësit e tjerë të këtij ushqimi të shëndetshëm, qepa e re Sunion aktualisht mund të blihet vetëm në Nevada dhe Washington. Prodhuesit e këtij produkti kanë vënë në dukje se janë duke u bërë përpjekje të mëdha që produkti i ri të plasohet në raftet e supermarketeve anembanë botës

390 p.e.s - Lufta romako-gale. Ushtria romake mundet nga rebelët Galë.
1290 - Mbreti Eduard I i Anglis; ka urdhëruar dëbimin e hebrejve.
1536 - Autoriteti i Papatit shpallet i pavlefshëm në Angli.
1572 - Uilemi i Portokalltë njihet si mëkëmbës i Holandës.
1630 - Trupat spanjolle okupojnë Mantuan.
1656 - Beteja e Varshavës: Mbreti i Suedisë Karli i X Gustavi mund Johanin e II Kasimir dhe okupon Varshavën.
1737 - Beteja e Banja Llukës: Ushtria turke mund austriakët.
1766 - Themelohet Shoqata e letrarëve të Holandës.
1864 - Kryetari Linkoln kërkon 500.000 vullnetarë për shërbim ushtarak.
1907 - Trupat franceze okupojnë Kazablankën.
1947 - Mbreti Xhorxh VI i Anglisë nënshkruan Aktin e pavarësisë së Indisë.
2012 - Kim Jong - Un zyrtarisht emërohet Udhëheqës suprem i Koresë së Veriut dhe i jepet rangu Marshall në Armatën Popullore të Koresë.



"Le ta zgjidhim si të rritur", shkruhet në etiketën e birrës së dalë në treg, me rastin e takimit në Helsinki, mes presidentit amerikan Trump dhe homologut të tij rus Putin. Birra është vënë në shitje në supermarketet e kryeqytetit finlandez. Kompania që ka prodhuar birrën, tregoi për mediat vendase, se fillimisht janë prodhuar 10 mijë shishe, dhe njëra prej tyre kushton 3.49 euro. Po me rastin e këtij takimi, kanë dalë në shitje dhe kafe speciale, në paketime prej 250 gramësh, si dhe bluza.

IKËN DRITAT

Një djalë 18 vjeç i tregon shokut ngjarjen që kishte përjetuar mbrëmë.

- Isha më të dashurën time tek shtëpia saj dhe papritur ikën dritat, tha djali.

- A e shfrytëzove rastin?, pyeti shoku.

- Po po, ja piva të gjithë Coca Colen, u përgjigj 18-vjeçari.



Shpirti i një personi është i fshehur në sytë e tij, ja pse shpesh kemi frikë të shihemi në sy...

(Jim Morrison)